



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

**DOKUMENTAT
STANDARDE TË PROCEDURËS SË HAPUR
PUNË**

**ME OBJEKT:
“Rikonstruksioni i linjës 110 kV Ulëz-Burrel”**

ME NR. REF-83122-12-24-2020

DHJETOR 2020

I. NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)
Adresa Tiranë, Kasha, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës Km. 9.
Tel/Fax _____
E-mail info@ost.al
Faqja e Internetit www.ost.al
Personi përgjegjës Napolon Troci e-mail: Napolon.Troci@ost.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qendror	Institucion i pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njesi e Qeverisjes Vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	Shoqeri Anonime me Kapital
	100% Shtetëror

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po Jo

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit REF-83122-12-24-2020

2.2 Lloji i “Kontratave për punë publike”

Realizimi i punëve	Projektimi dhe realizimi i punëve
<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po Jo

2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me 1 Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po Jo

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloji Marrëveshje Kuadër

--

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të përfundojë Marrëveshja Kuadër: _____ (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike.	
------------	---	--

2.7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër:

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës **41,642,417 (dyzet e një milion e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.**
2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është _____
3. Burimi i Financimit **Të ardhurat e OST sh.a.**
4. Objekti i kontratës / marrëveshjes kuadër **“Rikonstruksioni i linjës 110 kV Ulëz-Burrel”.**

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj **12 (dymbëdhjete)**

ose

duke filluar nga me përfundim në

2.9.1 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: ose **ditë:** (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër (jo më shumë se (4) vjet)

Ose

duke filluar nga (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më (dd/mm/vvvv)

2.10 Vendndodhja e objektit të kontratës/marrëveshjes kuadër:

Linja 110 kV Ulëz-Burrel, sipas Specifikimeve Teknike (Shtojca 13) e DT.

2.11 Ndarja në LOTE:

Po Jo

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Objekti dhe fondi limit i loteve)

1. _____

2. _____

3. _____

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka):

Ose: nga në

2.14 Do të pranohen variantet:

Po Jo

2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:

Po Jo

Nese do te lejohet nenkontraktimi, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: **deri në 40% të vlerës së kontratës.**

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po **X** Jo

Shenime te tjera

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimi sipas Shtojcës 8.

3.2 Sigurimi i ofertës¹ (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është _____ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 _____ Lekë

Loti 2 _____ Lekë

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës: E hapur

Procedurë prokurimi e rishpallur

Po Jo **X**

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anuluar

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimit të anuluar _____

c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anuluar _____

¹ Sigurimi i ofertes nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët X

Ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme

lidhur me rëndësinë: Çmimi pikë
etj. pikë

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **27/01/2021** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **27/01/2021** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: Drejtoria e Prokurimeve OST sh.a.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: (e shprehur në ditë)

4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip Anglisht

Tjetër _____

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po Jo

Nëse Po

Monedha _____ Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **28/12/2020**

Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)	
Adresa	Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9	
Tel/Fax	+355 4 2225581/ +355 4 2225581	
E-mail	info@ost.al	
Faqja në Internet	www.ost.al	
Personi i Kontaktit:	Napolon Troci	e-mail: Napolon.Troci@ost.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur - me mjete elektronike – Punë

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Rikonstruksioni i linjës 110 kV Ulëz-Burrel”.

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-83122-12-24-2020

5. Fondi limit 41,642,417 (dyzet e një milion e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 (dymbëdhjete) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Dt .27.01.2021, ora 10:00, Faqja zyrtare e website-it të Agjencisë së Prokurimit Publik, www.app.gov.al

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Dt.27.01.2021, ora 10:00, Drejtoria e Prokurimeve, OST sh.a., Tiranë Kashar Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9.

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Seksioni 1. Hartimi i ofertës

- 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.
- 1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 1.3 (*opsion*) Do të organizohet një vizitë në kantier në _____ (dd/mm/vv) në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime dhe të cilat do tu shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomikë. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem kontaktoni: (përcaktoni personin e kontaktit)

- 1.4 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertes duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.
- 1.5 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.
- 1.6 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.

1.7 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formularin e Ofertës (Preventivi), plotësuar sipas Shtojcës 1.

b) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1.

c) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, projekte, etj*)

_____,
_____,
_____.

- c) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 12.
- d) (opcion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Me plotesimin e Shtojcës “Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës,, operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në tërësi.

1.8 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

1.9 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për ekzekutimin e punëve; Nr. e Njoftimit.

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv _____ orës _____”.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

1.10 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t’i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfë që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM OFERTE”** ose **“TËRHEQJE OFERTE”**.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund të modifikojë në çdo kohë ofertën deri para afatit kohor përfundimtar për dorëzimin e ofertave pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

Seksioni 2 Përlllogaritja e ofertës ekonomike

2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar punët që do të realizohen, sasinë dhe çmimin e tyre për “kontratat me çelsa në dorë” dhe “çmimet fikse” për kontratat e punimeve me matje .

2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH-ne. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës

së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

- 2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në preventiv çmimet për cdo zë punimi dhe çmimin total të ofertës të të gjitha punëve, pa TVSH. Vlera e TVSH-se, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 2.4 Përveç kur Dokumentat e Tenderit e parashikojnë ndryshe, çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor si e papranueshme.
- 2.5 Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet nuk janë përcaktuar çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara ato janë objekt i ndryshimit pas një Mini-konkursi në mes të palëve në marrëveshjen kuadër.
- 2.6 Sigurimi i Ofertës kur kërkohet duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.
- 2.7 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
 - a) garanci bankare
 - b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet bashkë me oferten para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.8 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një

sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

2.9 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së.

Seksioni 3. Vlerësimi i Ofertave

3.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertes së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min}k1 \times P_{max}k1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmin k1 _____ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Sqarim: Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e pajis njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë

komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.3 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, sipas shëmbujve të mëposhtme:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumata në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,
- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumata në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojnë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

3.4 Ofertat anomalisht të ulëta

3.4.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me punët e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.4.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përlogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta

M_O – Mesatarja e Ofertave të vlefshme

n – Numri i Ofertave të vlefshme
 Z_M – Zbritja e Mundshme

$$M_o = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$$

$$Z_M = 85 \% M_o$$

Vlera e Ofertës që vlerësohet $<..Z_M.....$, si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

3.5. Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

Seksioni 4. Nënshkrimi i Kontratës

4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 16. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 20 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare,
- b) garanci sigurimi.

Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore ne rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.

4.2.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Shënim: Autoritetet kontraktore nuk duhet të nderhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 1/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur

Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë në rastin e marrëveshjes kuadër

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklarate mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik

Shtojca 6: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër

Shtojca 7: Deklarata mbi konfliktin e interesit

Shtojca 8: Deklaratë mbi përmbushjen e Kriteve Të Përgjithshme per Kualifikim

Shtojca 8/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Shtojca 9: Formular vleresimi

Shtojca 10: Deklarata e disponueshmërisë së makinerive

Shtojca 11: Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces

Shtojca 12: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes

Shtojca 13: Projekt-zbatimi dhe specifikimet teknike

Shtojca 14: Preventivat

Shtojca 15: Formulari për Njoftimin S'kualifikimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Fituesit për operatorët ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër

Shtojca 18: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 19: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 20: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 21: Formulari i Ankesës ne Autoritetin Kontraktor

Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Shtojca 23: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Shtojca 24: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar

Shtojca 25: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike

Shtojca 26: Formulari i Njoftimit të Anullimit

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total
1.		Sipas Preventivit të punimeve (Shtojca 14)	Komplet	1		
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTALE						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 1/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Punëve të mëposhtme:

.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratë dhe sasive siç përkufizohet në Dokumentacionit të Tenderit (DT)).

Vendi i kryerjes së punës

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Afati i punimeve _____

Oferta duhet të paraqitet

.....

[Jep adresën e saktë]

Përpara

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Me shkrim

elektronike (email, fax, etj)

Shtojca 3

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-së

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE REALIZIMIN
E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TE PUNIMEVE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Punë: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP².

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

² Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 8/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE
NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULAR VLERËSIMI

(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VËRTETOJ SE:	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/ Bashkimit të operatorëve NIPTET/ Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS³

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

³ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- d. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Ne permbushje te kapacitetit ekonomik dhe financiar operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar xhiroja mesatare vjetore, gjate tre viteve te fundit financiare, ne një vlerë te pakten prej 20,000,000 (njëzet milion) leke.*

Operatoret ekonomik qe kane aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet te kene xhiro mesatare, ne vleren e kerkuar te pakten prej 20,000,000 (njëzet milion) leke.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura ose kopje të certifikuara të bilanceve.

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pervoje te suksesshme ne ekzekutimin te pakten:*

- a. *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë te pakten 20,000,000 (njëzet milion) leke dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit te tenderit; ose*
- b. *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, nga data e zhvillimit te tenderit, është ne nje vlere te pakten sa 80,000,000 (tetëdhjetë milion) leke.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme lidhur me kete kriter.

Lidhur me keto pika ofertuesi duhet te paraqese:

- Shtojcen 9 te plotesuar /Vertetim per realizim kontrate;
- Kontraten/at me entet publike, kurse me sektorin privat nese eshte e mundur.
- Akt-kolaudimi/e,
- Situacionin/e punimesh,
- Fature/at tatimore.

Shënim: Kontrata te ngjashme persa i perket punimeve elektrike per vete specifiken qe kane, do te kosiderohen punimet ne Linjat elektrike me nivel tensioni \geq 110 kV.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale ne fushen e projektimit ose te kete marrveshje kontraktuale me disponuesit e ketyre licencave, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorit e meposhtme:*

- | | |
|--|----------------|
| Projektues konstruktor | - Pika 3/b |
| Projektues instalator | - Pikat 4/c |
| Projektues gjeodet | - Pikat 8/a, d |
| Projektim impianteve te shpernd. en. elektrike | - Pika 10/ d |

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues ose personi fizik apo juridik qe disponon licencat e projektimit dhe qe ka marrveshje kontraktuale me ofertuesin per realizimin e projektit, duhet te dispoje: Program te licencuar “PLS CADD and TOWER” ose te ngjashem.*

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorite e meposhtme:*

Punime te pergjithshme ndertimi:

Kategoria NP-1	Punime germimi ne toke	Klasifikim A
Kategoria NP-2	Ndertime civile dhe industriale	Klasifikim A
Kategoria NP-11	Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatorve, linjat TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	Klasifikim B
Kategoria NS-18	Punime topogjeodezike	Klasifikimi A

Shenim :

- i. Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.**

2.3.5 *Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”.*

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier ndertimi, 1 (nje) inxhinier mekanik, 1 (nje) inxhinier elektrik, 1 (nje) inxhinier topograf/Gjeodet. Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 12(dymbedhjete) muajt e fundit.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperm si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per realizimin dhe zbatimin e kontrates. Numri i punonjesve te siguar duhet te jete jo me pak se 15 (pesembedhjete) punonjes per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit, nga data e zhvillimit te tenderit.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim te leshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore ne te cilin te jete i percaktuar numri i punonjesve te siguar, shoqeruar me listepagesat perkatese E-Sig, per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 5 (pese) punonjes, te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, nga te cilet 3 (tre) te jene punonjes me kategorine e sigurimit teknik IV-V, te leshuar nga shoqeri te akredituara ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr. 13/2013, date 14.02.2013.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- i) listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar si dhe
- ii) kartelat perkatese te vlefshme te sigurimit teknik.

2.3.9 *Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 7(shtate) punonjes te trajnuar dhe te pajisur me certifikate te punimeve ne lartesi te leshuara nga shoqeri te licensuara nga ministria perkatese, te cilet te jene te siguar te pakten per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- i) Çertifikatat e punonjesve per punimet ne lartesi
- ii) licencen e shoqerise e cila ka trajnuar punonjesit e operatorit ekonomik.
- iii) listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar

2.3.11 *Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 (nje) manovrator te pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organet kompetente, i cilit te jete i siguar te pakten per 12 (dymbedhjete) muajt e fundit, nese automjetet jane ne pronesi te OE ofertues. Ne rastin kur automjetet merren me qera, manovratori i pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, mund te kontraktohet nga OE ofertues per realizimin e kontrates objekt prokurimi. Ne lidhje me manovratorin e makinerive te renda te paraqiten deshmitet e drejtimit te leshuar nga Ministria perkatese.*

2.3.10 *Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :*

Nr	Mjetet	Sasia
1	Eskavator me kove	1 cope
2	Fadrome	1 cope
3	Autobetoniere	1 cope
4	Autovinc	1 cope
5	Kamion	1 cope
6	Motoarganello	2 cope
7	Vinc tip falkone (pa motoarg.)	2 cope
8	Makineri terheqje percj.,tros, opgw	1 sete
9	Makineri leshuese (frenuese) percj.,tros, opgw	1 sete
10	Instrument për matjen e dispresionit kromatik me shtrirje dinamike min 55 db	1 cope

Si deshmi për plotesimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

1. Shtojcën Nr. 10 të plotësuar.
2. Për mjetet, makineritë dhe pajisjet në pronësi të paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)
3. Për mjetet, makineritë dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje (ose formë tjetër huaje) si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit të bërë me lart. Kontrata e qerasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve.
4. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi) dhe akti i kolaudimi.

2.3.11 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:*

- a. ISO 9001: certifikatën e menaxhimit të cilësisë së punimeve, që kanë lidhje me objektin e kontratës;
- b. OHSAS 18001: ose ISO 45001: certifikatën e sistemit të menaxhimit të sigurisë në punë, në lidhje me objektin e kontratës;
- c. ISO 14001: për sistemin e menaxhimit mjedisor, në lidhje me objektin e kontratës.

2.3.12 *Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë:*

Licence leshuar nga QKB për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis me kod III.2.A.

Licence leshuar nga QKB për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me kod III.2.B (transportimi i mbetjeve të llojeve të ndryshme).

Nëse Operatori Ekonomik ofertues nuk i disponon këto licensa atëherë ai mund të bëjë një marrëveshje kontraktuale me personin fizik apo juridik që i disponon këto licensa.

2.3.13 *Për listën e mëposhtme të mallrave:*

1. Percjelles, sipas specifikimeve teknike
2. Denfera, sipas specifikimeve teknike

3. Izolatore, sipas specifikimeve teknike
4. Set morseteri, Sipas specifikimeve teknike
5. Boje, sipas specifikimeve teknike.

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

1. *Autorizim te prodhuesit/ve/distributorit te autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalog/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/per listen e materialeve te mesiperme qe do te ofrohen, ne te cilen te paraqiten te dhenat teknike baze te perkthyer ne gjuhen shqipe.*

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi te kryera me pare, qe vertetojne pajtuesmerine e materialeve te prodhuara (lista e mesiperme ose te ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

2.3.14 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape me nje vetedeklarim, te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal (i cili eshte i shenuar ne dokumentin e identifikimit), shoqeruar dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, dhe drejtues te ndryshem te shoqerise (perfshire te gjithë ato teknike qe jane ne licencen e shoqerise).*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shenim: Në respekt të nenit 23 të LPP – së, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 110 KV ULËZ – BURREL

SPECIFIKIMET TEKNIKE

PERMBAJTJA

1 OBJEKTI I FURNIZIMIT DHE PUNIMET

1.1 Qellimi i projektit

1.2 Objekti i Furnizimit

1.3 Punime nga te tjeret, kufijte ndares

- 1.3.1 Kontributi i punedhenesit
- 1.3.2 Kontraktore te tjere

1.4 Kerkesat kryesore

- 1.4.1 Njesite e matjes
- 1.4.2 Materialet
- 1.4.3 Standartet dhe kodet
- 1.4.4 Materialet dhe punimet

1.5 Garancite dhe Penalitetet

- 1.5.1 Garancia e pergjitheshme
- 1.5.2 Vlerat e garantuara

1.6 Inspektimet dhe Provat ne Fabrike

- 1.6.1 Te pergjitheshme
- 1.6.2 Pranimi i provave
- 1.6.3 Testimet gjate komisionimit
- 1.6.4 Paisjet e difektuara

1.7 Paketimi dhe Transporti

- 1.7.1 Marketimet, emertimet dhe paketimet
- 1.7.2 Transporti i materialeve dhe paisjeve

1.8 Montimi dhe komisionimi

1.9 Informacione per Punedhenesin

2. LINJA 110 KV ULEZ – BURREL

2.1 Te pergjithshme

2.2 Pershkrimi i impiantit

- 2.2.1 Vendndodhja e linjes
- 2.2.2 Kushtet klimatike

2.3 Qellimi i furnizimit dhe paisjeve

2.4 Percjellesi

- 2.4.1 Percjellesi i fazeve dhe specifikimet teknike
 - 2.4.1.1 Projekti
 - 2.4.1.2 Kerkesa per shigjetat dhe tensionimet
 - 2.4.1.3 Testimi
 - 2.4.1.4 Pjeset rezerve
 - 2.4.1.5 Paketimi, dergimi, transporti

- 2.4.2 Shtyllat
 - 2.4.2.1 Materialet
 - 2.4.2.2 Detajet
 - 2.4.2.3 Prodhimi
 - 2.4.2.4 Testimi i shtyllave ne ngarkese
 - 2.4.2.5 Paketimi
 - 2.4.2.6 Garancia e cilesise

- 2.4.3 Izoloret dhe armatura
 - 2.4.3.1 Te pergjithshme
 - 2.4.3.2 Izoloret dhe Girlandat e izoloreve
 - 2.4.3.3 Izolore prej xhami te temperuar
 - 2.4.3.4 Morsetat dhe armatura per percjellesit

- 2.4.4 Qetesuesit
 - 2.4.4.1 Kerkesat

- 2.4.5 Ndertimi, terheqja e percjellesve, komisionimi
 - 2.4.5.1 Te pergjithshme
 - 2.4.5.2 Siguria dhe supervizioni
 - 2.4.5.3 Pastrimi i trasese
 - 2.4.5.4 Shtrirja dhe terheqja e percjellesve dhe OPGW
 - 2.4.5.5 Instalimi i izolacionit dhe armatures
 - 2.4.5.6 Kontrolli dhe testimi perfundimtar

2.5 Specifikimet teknike për lyerjen me bojë të shtyllave metalike

- 2.5.1 Të përgjithshme
- 2.5.2 Vëllimi i furnizimit dhe shërbimet

- 2.5.3 Vendi i kryerjes së punimeve
- 2.5.4 Siguria në punë
- 2.5.5 Kërkesa teknike

2.6 Tabelat e te dhenave teknike

1. OBJEKTI I FURNIZIMIT DHE PUNIMET

1.1 Qellimi i projektit.

Si objekt i punes se ketij projekti do te jete fuqizimi dhe lysterja me boje e te gjitha shtyllave egzistuese te linjes 110 kV Ulez – Burrel. Fuqizimi i linjes konsiston ne zevendesimin e percjellesit egzistues ALC 95 mm² ne percjelles te ri ALC 120 mm². Persa i perket shtyllave egzistuese ato ruhen dhe do te lyhen me boje vaji dhe antiruxho

Rikonstruksion i kesaj linje behet i domosdoshem ne kushtet kur linja ekzistuese eshte e amortizuar duke mos ju pergjigjur rritjes se ngarkesave te nevojshme te energjise elektrike. Ndertimi i kesaj linje do te sherbeje edhe per plotesimit te kriterit te n-1 burimeve

1.2 Objekti i Furnizimit

Kontraktori do te siguroje mallrat dhe sherbimet sipas nje kontrate baze ku do perfshihen: demontimi i linjes se vjeter, prodhimi, furnizimi, instalimi, testimet dhe komisionimi i paisjeve qe furnizohen ne kuadrin e kesaj kontrate.

Kontraktori detyrohet te siguroje komplet paisjet si dhe instalimin perkates per objektin e parashikuar ne kete Kontrate si me poshte pershkruhet, duke dhene skedulim e sasive dhe çmimeve per sejcilen nga kerkesat.

Furnizimi i detajuar dhe punimet qe do perfshihen ne kete Kontrate jane pasqyruar ne dokumentacionin dhe tabelat perkatese te zerave te punimeve bashkengjitur dhe permbledhen si me poshte:

Seksioni i pare:

- a) Zevendesimi i percjellesit ALC 95 mm² i linjes ajrore 110 kV Ulez – Burrel. Percjellesi i ri qe do vendoset ne linje do jete ALC 120 mm². Gjatesia totale e linjes ne plan eshte 16.3 m me percjelles 95 mm², ku perfshihen:
 - furnizimi,
 - instalimi,
 - testimet dhe vendosja ne pune e saj

- b) Lysterja me boje e te gjitha shtyllave egzistuese te linjes 110 kV Ulez – Burrel. Numri i shtyllave qe do te lyhen eshte 57 .

- c) Nderrim i morseterise dhe izolatoreve per te gjithë ghirlandat
- d) Riparimi i kokave te betonit te bazamenteve dhe nderrimi ose perforcimi i ndonje elementi profile metalike L teje te korroduar

Objekt i kontrates se ketij rikonstruksioni do te jete edhe demontimi i percjellesit te linjes ekzistuse, si dhe çdo punim tjetër qe mund te mos jete cituar me siper, por qe eshte i domosdoshem per implementimin e projektit ne perputhje me standartin e kerkesave teknike.

Kerkese e rendesishme ndaj Kontraktorit eshte se punimet duhet te kryhen ne menyre te tille qe te sigurohet vazhdimesia e punes normale te HEC Shkopet dhe te HEC Ulez duke shkaktuar kohën minimale te ckycies se linjes. Pra punimet duhet te kryhen me stakim me hapje flete pune ne mengjes dhe kthim skeme ne darke cdo dite.

Ne oferte duhet te pasqyrohet nje plan i detajuar mbi implementimin e projektit ne te cilin te jepen edhe nderprerjet e nevojshme te energjise elektrike si masat provizore qe duhen ndermarre per realizimin e ketij projekti.

1.3 Punime nga te tjeret, kufijte ndares

1.3.1 Kontributi i Punedhenesit

Punedhenesi nuk do te furnizojë ndonje paisje dhe asnje sherbim tjetër (asnje pune paraprake ne objekt), veçse te dhenat ktyesore teknike qe jepen ne keto specifikime.

1.3.2 Kontraktore te Tjere

Nuk ka Kontraktore te tjere te perfshire ne kete projekt.

1.4 Kerkesat kryesore

1.4.1 Njesite e matjeve

Kontrata do kete per baze Sistemin International (SI) ne perputhje me ISO 31 dhe ISO 1000.

1.4.2 Materialet

Te gjitha materialet do jene te reja dhe te kualitetit me te mire ne perputhje me specifikimet teknike, per tu perballur me kushtet atmosferike dhe ngarkesat e punes pa pesuar shkaterime dhe difekte te asnje elementi.

1.4.3 Standartet dhe kodet

Punimet do të kryhen në përputhje me kodet dhe standartet më të fundit. Duhet të permbushen standartet IEC dhe praktikatat rekomanduese.

Të gjitha materialet dhe pajisjet që do furnizohen si dhe të gjitha punimet që do të kryhen për kalkulimet, duhet të permbushin me rigorozitet kodet teknike të International Organization for Standardization (ISO) dhe rekomandimeve IEC që zbatohen në pajisjet dhe instalimet elektrike.

Mallrat dhe garancite speciale që janë pas skopit të ISO dhe IEC duhet të plotësojnë të paktën standartet dhe kodet sipas prioritetit të mëposhtem:

- EN, DIN, BS, ASTM, VDE
- Punimet civile (standartet shqiptare)
- Standarte të tjera ndërkombëtare të pranuar që sigurojnë kualitet të barabartë ose më të lartë se ato të përmendura më sipër.

Kontraktoret duhet të jenë të certifikuar sipas ISO 9001:2008 për sistemin e menaxhimit të cilësive së punimeve që kanë lidhje me objektin që ndërtohet.

Të gjitha pajisjet duhet të inspektohen dhe testohen në përputhje me kërkesat e këtyre standarteve dhe kodeve si dhe të specifikimeve të paraqitura.

Në të gjitha rrethanat, standartet dhe kodet finale që do pranohen do jenë publikimet më të fundit para datës së hapjes së tenderit.

Kur nuk ka standarte të pershtatshme, testimet do të kryhen në përputhje me praktikatat dhe standartet e fabrikës, të cilat duhet të aprovohen nga përfaqësuesi i Punëdhënesit. Në këtë rast, Kontraktori paraqet të dhënat dhe procedurën e plotë për testimet që do të kryhen, para fillimit të fabrikimit.

Pajisjet kryesore dhe ndihmëse që specifikohen në Technical Specification duhet të projektohen dhe fabrikohen sipas publikimeve më të fundit të standarteve siç tregohen më poshtë:

- EN 50 182 Përcjellesit dhe trosi i linjes
- IEC 61 284 Aksesoret e linjes dhe OPGW
- IEC 60071-1 Specifikimet e izolacionit – pjesa 1: Përcaktime, principe dhe rregulla.
- IEC 60529 Shkalla e mbrojtjes së dhënë sipas kodit IP

Materialet lidhen dhe fiksohen si bulona dado, vida etj. do jenë metrike sipas standarteve përkatëse DIN.

1.4.4 Materialet dhe punimet

Materialet e përdorura në fabrikimin e pajisjeve të specifikuara do të jenë shumë të mira në cilësi fizike dhe më të pershtatshme për qëllime të ndryshme përdorimi në përputhje me praktikatat më të mira inxhinierike. Të gjitha pajisjet do jenë konforme standarteve të aplikueshme për materialet, punën, projektimin dhe provat.

Të gjitha pajisjet dhe konstruksionet do jenë të qëndrueshme ndaj korrozionit dhe përdorimeve të shpeshta.

Te gjitha punimet do kryhen sipas rregulles se artit dhe do ndjekin praktikat me te mira inxhinierike. Kontraktori duhet te siguroje kryerjen e te gjitha sherbimeve te kerkuara ne ekzekutimin e punimeve, edhe pse ndonjera nuk eshte specifikuar ne Kontrate.

1.5 Garancite dhe Penalitetet

1.5.1 Garancia e pergjitheshme

Ofertuesi dhe Kontaktori garantojne se:

- E gjithë puna dhe materialet do jene konforme specifikimeve dhe standardeve respektive
- E gjithë puna dhe materialet do jene konsistente me inxhinieringun, fabrikimin dhe procedurat dhe do plotesojne standardet me te larta te kujdesit dhe mjeshterise.
- Te gjitha materialet, pjeset dhe aksesoret do te jene te reja, te prodhimeve me te fundit, pa asnje difekt, te kualitetit maksimal te mundeshem, te pershtateshme per qellimin qe kerkohen, te permasave dhe kapaciteteve te mjaftueshme, ne rrespekt te plote me kerkesat dhe kushtet e operimit qe specifikohen ne kete Kontrate.

1.5.2 Vlerat e garantuara

Kontraktuesi do te specifikojë ne nje liste te vecante te gjitha paisjet qe perjashtohen nga specifikimet e dhena te titulluar: "Perjashtime nga specifikimet e punedhenensit"
Kontraktuesi do garantoje performancen e paisjeve te furnizuara per jetegjatesine e parashikuar.

Vlerat qe duhet te garantohen permenden dhe identifikohen si te tilla ne skedulet e te dhenave teknike. Kontraktori duhet te garantoje keto vlera. Punedhenesi gezon te drejten te refuzoje ndonje paisje qe nuk i respekton keto vlera.

1.6 Inspektimet dhe Provat ne Fabrike

1.6.1 Te Pergjitheshme

Testimet do te kryhen ne Fabrike ose ne ndonje laborator te pershtateshem ne perputhje me Specifikimet Teknike.

Testimet do permbajne te gjitha testet e nevojshme per te provuar qe materialet dhe paisjet plotesojne Specifikimet Teknike dhe kushtet e projektimit.

Rezultatet e provave do rregjistrohen ne test-raporte te cilat do kene gjithashtu dhe te dhenat teknike specifike.

Certifkatate testimi do tregojne rezultatin aktual dhe kushtet ne te cilat jane kryer provat, qarqet e testuara, oshigramat etj.

1.6.2 Pranimi i provave

Pranimi i provave do ndahet ne dy tipe testimesh, teste rutine dhe, nese speifikohet teste special.

Provat tip do behen me perpara dhe siç specifikohen ne publikimet perkatese IEC.

Testet Rutine do behen ne cdo element te paisjes qe do furnizohet.

1.6.3 Testimet gjate Komisionimit

Me arritjen ne objekt dhe gjate periudhes se montimit, te gjithë element e paisjeve do inspektohen dhe testohen per tu siguruar se jane ne rregull dhe keshtu nuk do kete vonesa ne komisionim per shkak te ndonje demtimi te mundeshem te paisjeve.

Testimet e komisionimit do perfshejne (por nuk do limitohen):

- Kontrolli dhe saktësimet nese ka dyshime
- Kontrolli mekanik i te gjitha tokezimeve
- Kontrolli i marketimeve dhe emertimeve ,etj
- Kontrolli i funksionimit te qarqeve te stakimit, sinjalizimit, matjes
- Kontrolli vizual i paisjeve te instaluara

Te gjitha provat do dokumentohen ne Test-raportet

1.6.4 Paisjet e Defektuara

Nese gjate testimeve te mesiperme, konstatohet ndonje problem ne montim, material i demtuar ose pjese te paisjeve qe nuk jane ne perputhje me specifikimet, Kontraktori, me shpejtesine me te madhe, do te marre masa per zgjidhjen e problemit. Nese Punedhenesi e kerkon pas zevendesimit do te perseritet testimi.

Kontraktori do perballoje te gjitha shpenzimet e Testimeve ne fabrike dhe ne objekt, perfsheire udhëtimin dhe shpenzimet e personelit perfaqesues te Punedhenesit edhe per testimet e perseritura.

1.7 Paketimi dhe Transporti

1.7.1 Marketimet, Emertimet dhe Paketimet

Kontraktori do pregatise per transport te gjitha paisjet dhe materialet ne menyre te tille qe ti mbroje ato nga demtimet gjate transportit dhe do jete pergjegjes per cdo demtim te shkaktuar nga mos ambalazhimi si duhet.

Para ambalazhimit paisjet dhe pakot do te emertohen dhe vendosen numrat dallues perkates, do pregatiten packing List per cdo kuti ambalazhimi.

Paketimet do kryhen me permasa te tilla qe te jene te mundeshme per transport.

1.7.2 Transporti i materialeve dhe paisjeve

Transporti me anije do behet nepermjet Portit Detar „Durrës“, Albania, ose nepermjet pikave kufitare doganore .

Ngarkesat do behen sipas “CIP Site”

Para ngarkimit ne anije Kontraktori do furnizojë me e-mail ose fax Punedhenesin me te gjitha dokumentet perkatese.

Punedhenesi do njoftohet ne perfundimin e transportit.

Te gjitha kutite dhe arkat do jene qartesisht te markuara dhe do te adresohen :

OST, Albania

1.8 Montimi dhe komisionimi

Objekti i Kontrates janë të gjitha shpezimet për testimet dhe inspektimet në objekt si puna, materialet, elektriciteti, magazinimet si dhe pajisjet dhe aparaturat e domosdoshme për kryerjen e Testimeve.

Kontraktori do sigurojë dhe pajisjet për masat e sigurimit në punë gjatë montimeve dhe kryerjes së provave në objekt.

Të gjitha materialet dhe pajisjet do të montohen në objekt sikundër tregohen në skemat dhe projektet e miratuara, dhe duke konsideruar teknikat me bashkëkohore të montimit.

Të gjitha pajisjet dhe instrumentat që kerkohen për kryerjen e Testimeve në objekt do të sigurohen nga Kontraktori.

Testimet do të bëhen konformë vëllimit të provave që do aprovohen që më parë nga punedhësi.

1.9 Informacione për Punedhësin

Konkuruesit në Tender do paraqesin dokumentet e mëposhtme:

Vizatime konturuese

Vizatime të pajisjeve që tregojnë dimensionet kryesore me minimumin e distancave të kerkuara ndaj pajisjeve fqinje, peshat, detalet ankorues, etj

Gent Planet

Vizatimet kryesore të montimit: Do tregohen me shkallë të gjithë komponentet e nevojshëm dhe do identifikohen në Legjendë. Do përfshihet sasia e saktë e tyre.

Test raportet

Tipi i test reporteve për pajisjet kryesore do paraqitet.

Mjetet e punës

Do japin detajimet teknike të mjeteve të punës që do përdoren

Dokumentet e planifikimit

Do paraqiten skedulet e punimeve, organizimi i punës në objekt, , transporti, etj

2. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LINJEN 110 kV ULEZ – BURREL

2.1 Te përgjithshme

Projekti i referohet linjes ajrore 110 kV me një qark Ulez - Burrel. Objekt i këtij rikonstruksioni do jetë ndërimi i përcjellesit të linjes ajrore nga përcjelles ALC 95 mm² në përcjelles ALC 120 mm² si dhe ljerja me boje të gjithë shtyllave egzistuese të kësaj linje.

2.2 Përshkrimi i impiantit

2.2.1 Vendndodhja e linjes

Zona e projektit ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Lartësia mbi nivelin e detit varion në përgjithësi nga 120 deri 354 m.

Bimesia është tipike mesdhetare me pak pyje, me shkurre. Zona ku do të ndertohet linja nuk është e populluar me banesa private.

2.2.2 Kushtet klimatike

Te dhenat Meteorologjike

Klima në zonen e ndertimit të linjes karakterizohet si mesdhetare me vere të thate dhe dimër kryesisht me shira jo të vrullshëm. Zona e projektit nuk është subjekt i stuhive të forta (si uragane ose tornado) dhe nuk është një zonë aktive vullkanike/termetore. Numri i ditëve me stuhitë me vetetime është vlerësuar 40-50.

Nga pikepamja e ndotjes zona e projektit është përgjithësisht e pastër pa ndotje detare ose industriale. Ajo ndodhet rreth 25 km larg detit.

Kushtet meteorologjike për projektim

temperatura min.e ambientit	-20 °C
temperatura max.e ambientit	40 °C
temperatura minimale e percjellesit	-20 °C
temperatura maksimale e percjellesit	75 °C
temp.mesatare vjetore	15 °C
temperatura për erën maksimale	5 °C
temperatura për akull	-5 °C
shpejtësia e erës në 10 m lartësi V_R	30 m/s
trashësia e akullit	5 mm

2.3 Qellimi i furnizimit

Ky kapitull tregon qëllimin e projektimit dhe instalimit si dhe të furnizimit të vendosjes dhe shërbimeve të nevojshme duke përfshirë të gjithë komponentet e nevojshme dhe shërbimet e përpunueshme por të nevojshme për tipin e kontratës me çelës në dorë.

Qëllimi i ndertimit të linjes së transmetimit 110 kV përfshin këto komponente dhe kushte kryesore:

Ndërthurja me pjesë të projekteve të tjera.

- a) Lidhja e linjes do të realizohet në portalet e nenstacioneve të HEC Ulez dhe portalet e nenstacionit të Komsit Burrel.
- b) Giralanda terheqese izolatoresh do të furnizohen dhe do të instalohen në portalet e sipër permendura. Percjellesit e fazeve do të perfundojnë gjithashtu në portalet e të dy nenstacioneve.
- c) Të parashikohet një shtesë e mjaftueshme e percjellesve të linjes në kampatën nga shtylla fundore në portal që do të zbrese nga ky i fundit tek pajisja e parë e nenstacionit.

Qellimi përfshin gjithashtu montimin dhe instalimin e të gjitha materialeve dhe pajisjeve të nevojshme, punimet civile për bazamentet dhe shtyllat, shtrirjen e tokezimeve nëntokë, testimet në objekt për komisionim si dhe dorëzimin e dokumentacionit.

Kontraktori do të pranojë si të vërteta të pakten punimet, detyrimet dhe shërbimet e mëposhtme për linjen 110 kV.

1. Prokurimi, prodhimi, testimi në uzinë, paketimi, sigurimi, transportimi, zhdoganimi, shkarkimi dhe magazinimi i të gjitha materialeve të kërkuara.
2. Montimi i percjellesit dhe giralandave të reja bashkë me morseteri
3. Pastrimi dhe lyeja e shtyllave
4. Dorëzimi i dokumentacionit "As Built" të objektit.
5. Heqja e gjithë mbeturinave, materialeve të ndërimit dhe punimeve të tjera ashtu siç duhet me qëllim që kantieri të mbetet i pastër dhe në kushte të pranueshme.

Kontraktori duhet të ekzaminojë me kujdes dokumentat e Kontrates dhe të gjitha kushteve që ndikojnë në ekzekutimin e punimeve dhe të vlerësojë gjitha mundësitë realizuese dhe nevojat.

Të gjithë materialet, fabrikimet dhe testimet do të jenë në pajtim me kërkesat e përkruara më poshtë dhe të detajuara në vizatime. Sidoqoftë, këto kërkesa teknike nuk kufizojnë përgjegjësinë e Kontraktorit për të realizuar të gjithë punimet dhe furnizimin e të gjithë aksesoreve brenda qelimit, në mënyrë që të bëjë komplet punimet dhe që të jenë të gatshme për funksionim. Asnjë paqartësi ose dykuptim në vizatimet apo në kërkesat teknike nuk do të çlirojë Kontraktorin nga përgjegjësia e furnizimit me materiale dhe punime cilësore.

Perfaqësuesi i Punëdhënësit ka të drejtën të kërkojë kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontrates. Kontraktori do të marrë përsipër përgjegjësi të plote për përshtatshmerinë dhe

saktesine e punimeve, qe kerkohen te realizohen. Ai mbetet pergjegjes per sigurimin e te gjitha te dhenave te nderthurjes me objekte te tjera jashte objektit te tij te punes.

Ofertuesi duhet te ofroje sasite ne perputhje me formularin e çmimeve. Keto sasi jane vleresuar per qellime tenderimi, te bazuara ne projektim. Ato nuk jane te vlefshme per porositjen e materialeve nga Kontraktori.

2.4 Percjellesi

2.4.1 Percjellesi i fazave dhe specifikimet teknike

a) Percjellesit dhe trosi

Ne linje do te vihete percjelles I tipit ACSR 120/20mm².

Vlerat maksimale te lejuara qe jane adoptuar ne projektim jane:

- Sforcimi Maksimal I lejuar gjate punes se telit	132.1 N/mm ²
- Sforcimi maksimal qe mund te duroje percjellesi.	314 N/mm ²
- E.D.S Everyday stress:	56 N/mm ²

b) Karakteristikat e percjellesit ACSR 120/20mm²

• Seksioni terthor I aluminit	120.05 mm ²
• Seksioni terthor I celikut	20 mm ²
• Seksioni terthor total	141.4 mm ²
• Diametri	15.5 mm
• Moduli I elasticitetit	77 kN/mm ²
• Koeficienti I bymimit linear	
• Ngarkesa makismale ne piken e keputjes	44500 N
• Rezistenca elektrike maksimale ne 20°C	0.2376 Ω/Km
• Numeri I fijeve te Aluminit	26 x Ø2.42 mm
• Numeri I fijeve te Celikut	7 x Ø1.90 mm
• Pesha per 1Km	491 Kg/Km

2.4.1.1. Projekti

Kontraktori do te kryeje te gjitha punimet ne menyre te kualifikuar ne perputhje me metodat moderne te inxhinieringut. Per me teper kontraktori duhet ti permbahet te gjitha rregullave qe perdoren ne prodhimin dhe dorezimin e mallrave dhe do te ndjeke instruksionet e perfaqesuesit te Punedhesisit.

Percjellesi qe do te perdoret do te jete i tipit ACSR 120/20 sipas DIN 48203 Part 11.

Standard Baze

- Per percjellesin e plote EN 50182
- Per percjellesat perberes
 - a) percjellesat aluminum EN 60889

b) percjellesat çelik	EN 50189
c) graso	EN 50326
d) per varjen e percjellesit	IEC 61395

Ne se kontraktori deshiron te bazoje tenderin e tij ne standarte apo kode te tjera vec atyre te specifikuar me siper p. sh. disa standarte specifike per vendin e prodhimit, ai mund ti specifikojte ne tender edhe ato standarte apo kode me te dhenat e plota dhe ti paraqese si plotesim kerkese minimale te standarteve te dhena. Kontraktori do te paraqese si pjese te tenderit edhe nje liste tabelare te ndryshimeve midis standarteve ose kodeve te perdorur nga ata pershkruar me siper.

Standartet apo kodet alternative jane subjekt i aprovimit nga perfaqesuesi i Punedhenesit.

Percjellesit do te jene te pershtatur per sherbim ne kushtet specifike klimatike te dhena ne karakteristikat kryesore si pershkruhet ne specifikimet teknike,.

Te dhenat kryesore te projektimit te percjellsave duhet te jepen ose plotesohen nga tenderusit ne tabelat e specifikimeve teknike. Te gjitha keto te dhena duhet te verifikohen nga llogarijet dhe provat sipas specifikimit. Kontraktori duhet te paraqese certifikatat e analizave duke dhene perqindjen dhe natyren e papastertive te aluminit . permbajtja e bakrit nuk duhe te kaloje 0.04 %.

Percjellesit duhet te jene te pershtatshem per sherbim per kushtet klimatike me karakteristika kryesore te specifikuara ne kapitullin 2.5; Te dhena teknike.

Percjellsat te jene projektuar dhe te kene nje konstrukt te tille qe te sigurojne sherbim te gjate me shfrytezim ekonomik dhe kosto te ulet mirembajtje. Ata do te jene te pershtatshem ne çdo aspekt per pune te vazhduar me parametra nominale si dhe gjate proceseve kalimtare ne kushtet klimatike te veçanta te ambientit.

Te gjithë materialet e perdorur ne kete kontrate do te jene te cilesise se larte dhe punimet do te jene de klasit te larte gje qe arrihet nepermjet projektimit dhe dimensionimit te te gjitha pjeseve ne menyre qe streset qe ushtrohen gjate punes ne percjelles te mos shkaktojne demtime apo shtremberime edhe ne kushtet me te egra si gjate instalimit ashtu edhe gjate sherbimit.

Duhet te behet kujdes i vecante gjate procesit te shtrirjes se percjellesit ne menyre qe te sigurohet tensionim i njejte ndermjet shtresave te ndryshme me qellim qe te shmanget reshqitja ose levizjet relative ndermjet shtresave os te shkaktohet formimi i kaviteteve gjate shtrengimit.

Ne rast se makinerite qe perdoren per prodhimin e percjellsave te aluminit, do jene perdorur per percjellsa te tjere te ndryshem si alumin i galvanizuar os celik, atehere prodhuesi duhet ti paraqese Punedhenesit nje certifikate qe makineria eshte pastruar si duhet para perdorimit te aluminit, lidhjeve te aluminit, galvanizimit ose celikut dhe se pecjellesi nuk ka ndotje.

Bashkimet e percjellsave te vecante te aluminit nuk lejohen ne shtresat perkatese te jashtme dhe ne rastet qe specifikohen sipas standarteve.

Ne shtresat e brendshme te aluminit te percjellsa te fazes , bashkimet jane te lejshme para terheqjes perfundimtare. Keto bashkime me ngjitje duhet te behen me presim te ftuhte e

ngjitje. Nuk do të lejohen bashkimet e bera në percjelles të vecante alumini me ngjitje me rezizstence.

Kur është e nevojshme ngjitja e aluminit do të behet në bobinen e percjellsit të aluminit para se të terhiqet në menyre që të mos dallohet në percjellsin e instaluar.

Në percjellsat e aluminit nuk duhet të ketë ngjitje, përveç rasteve kur percjellsat thyhen gjatë shtrirjes dhe në këto raste, numri i nyjeve dhe lajmerimi për ekzistencën e ngjitjeve duhet të komunikohet përfaqësuesit të Punedhësit me leter që duhet të arrijë përfaqësuesit të Punedhësit brenda 7 ditëve para dorezimit të mallit në magazinë dhe pozicioni i ngjitjes duhet shënuar me shirit të kuq në çdo anë të ngjitjes në percjellesin e përfunduar. Përveç kësaj pjesë e jashtme e barabanit duhet të shënohet me germen W.

Kontraktori duhet të sigurojë që projektimi dhe vendosja e percjellsit është e tillë që të mund të verifikohen tolerancat e vendosura dhe specifikuar në standartet dhe në kërkesat e vecanta të këtij dokumenti tenderi. Vecoritë dhe garancitë e kërkuara në specifikimet teknike do të garantohen brenda tolerancave të lejuara nga standartet përkatëse dhe këto të dhëna e kushte janë pjesë e kontratës. Nëse vlerat e garantuara nuk arrihen atëherë përfaqësuesi i Punedhësit mund të kthejë atë pjesë të mallrave me shpenzimet e kontraktorit.

Nëse rezistenca elektrike për kilometër e percjellsit në ndonjë baraban i kalon vlerat e rezizstencës së garantuar të vendosura në specifikimet teknike, përfaqësuesi i Punedhësit mund ta kthejë barabanin me defekt për këto arsye.

2.4.1.2 Kërkesat për shigjetat dhe tensionimet

Percjellsin do të terhiqet në baze të këtyre kritereve të tensionit/stresit maksimal:

a) Kushte për tensionin mesatar vjetor:

Në temperaturën mesatare vjetore (15°C) dhe pa erë tensionit/stresit përfundimtar horizontal nuk duhet të kalojë **20%** të tensionit /ngarkesete llogaritur të keputjes ose vlerën minimale të garantuar të stress/ngarkesete llogaritur të keputjes të treguar nga prodhuesi.

b) Kushtet e ngarkesës maksimale:

Për kushtet e ngarkesës maksimale që mund të jenë:

- era max e marrë parasysh në projekt, ose
- ngarkesa e akullit e pa erë, ose
- ngarkesa e akullit e me erë të reduktuar, ose
- temperatura minimale.

Percjellsin duhet të ketë, brenda gjendjes limit të pershtatur sipas metodës së projektimit, këto faktore të sigurisë së përshtatshme:

- faktore i përshtatshëm i sigurisë për veprim: 1.35
- faktore i përshtatshëm i sigurisë për materiale: 1.25.

Ofertusi duhet të japë të dhënat e shtrengimit të përcjellsit (fillestare dhe përfundimtare) të llogaritura për kampatë të ndryshme linje në diagrame ose në formë tabelare, shigjeten dhe tensionin për temperaturë ndërmjet 0°- 60°C.

2.4.1.3 Testimi

Te përgjithshme

Kontraktori duhet të ofrojë një procedurë të detajuar për Sigurim të Cilësisë përfshirë një Inspektim dhe Plan të Testimit (ITP), i cili do të dorëzohet për të Punedhësit për miratim. Kontraktori do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara gjatë prodhimit të përcjellesve.

Të gjitha materialet e përdorura në prodhimin e përcjellesve duhet të mbulojnë me certifikata prove deklaruar provat e tyre mekanike dhe kimike për të provuar pajtueshmërinë me kërkesat teknike dhe EN 50182 ose IEC sipas rastit. Certifikatat / të dhënat e mëposhtme të testimit do të dorëzohen për miratim:

- certifikate prove të materialve metalike
- certifikate për mos kontaminim të paisjet thurëse
- regjistrimet e testit të galvanizimit.

Certifikatat ekzistuese të testimit të tipit të dorëzuar do të jetë më i vjetër se 10 vjet.

Përcjellesi

Provat e kampioneve do të behen sipas kërkesave të EN 50182

Fortësia në tensionim duhet të testohet sipas EN 10002. Provat mekanike duhet të behen në kampione të shtrirë të telave të vecantë pas vendosjes së përcjellsit. Në kushtet e kampioneve të çdo gjatësie që nuk kalojnë proven mekanike ose të rezistencës, një kampion i dytë ose i tretë do të merret me të njëjtin gjatësi dhe nëse edhe ndonjëri prej tyre nuk kalon proven atëherë do të kthehet komplet barabani nga i cili janë marrë këto kampione prove. Për provat e epshmerisë nëse do të ndodhë ndonjë ndryshim në rezultatin ndërmjet metodave të provave përdredhjes dhe zgjatjes atëherë do të merret parasysh rezultati i përdredhjes.

Prova e thurjes do të behet sipas ISO 7802.

Provat për përcjellesa celiku të galvanizuar do të kryhen në punë për të siguruar përputhjen me normat IEC 60888.

Trashësia e galvanizimit do të testohet sipas rastit. Veshja e zinkut duhet të përshtatet me kërkesat për trashësi të ISO 1461.

Hollësitë e rezultateve të provave do të paraqiten përfaqësuesit të Punedhësit sipas kërkesës për aprovim.

Graso

Propozimet e prodhuesit për prova tip që tregojnë përputhjen me kërkesat teknike duke patur parasysh cilësitë e mëposhtme të grasos do të paraqiten përfaqësuesit të Punedhënesit për aprovim.

- Provat e renes së pikave të grasos.
- Testi i lëngështimit të grasos
- Prova të historisë termike
- Rikthyeshmeria
- Oksidimi
- Lende korrozive në graso
- Vetite anti-korrozion.

Shembulli i testit të grasos sipas EN 50326 duhet të konsiderohet në të njëjtën kohë si test i përcjellesit. Pësha dhe gjatësia e kampionit të përcjellesit do të matet dhe shënohet. Mostra duhet të inspektohet për të konstatuar se asnjë shenje graso nuk është e dukshme në pjesën e jashtme. Pastaj telat përberës të përcjellesit do të ndahen progresivisht shtresë pas shtresë duke kontrolluar për të verifikuar nëse kërkesat e veshjes janë përmbushur.

Graso për testin e pikezimit në renie do të hiqet pa ngrohje, graso e mbetur atëherë mund të hiqet me një metodë të përshtatshme. Pësha e kampionit të përcjellesit të pastruar do të përcaktohet dhe regjistrohet. Pësha e grasos do të përcaktohet nga ndryshimi i peshave dhe do të regjistrohet.

Certifikata e provës

Të gjitha materialet metalike të përdorura në prodhimin e përcjellesave do të kenë certifikatat e provës që tregojnë cilësitë e tyre mekanike dhe termike ose për të provuar përmbushjen e normave të standarteve të EN ose IEC.

Keto certifikata do të jepen përfaqësuesit të Punedhënesit sipas kërkesës.

Regjistrimet e provave që mbulojnë provat tip dhe ato me kampion do të jepen përfaqësuesit të Punedhënesit.

Kur kërkohen kopje të këtyre certifikatave edhe ato do të dergohen:

- Çertifikata e provës për materialet metalike;
- Çertifikata e provës së përcjellesit të pandotur ;
- Prova e regjistrimit të galvanizimit;
- Çertifikata e shtresës së zinkut ;
- Prova e regjistrimit të aliazhit të aluminit.

2.4.1.4 Pjesët rezerve

Përcjellesat rezerve, sipas listës së çmimeve do të dergohen me ngarkesën e fundit në barabancë celiku të pakeputur që nuk do të kthehen si specifikohet. Nëse ndonjë sasi shtesë duhet të porositet, çmimet mund të jenë subjekt i rregullimit.

Përcjellesit rezerve duhet të mbrohen në mënyrë përshtatshme ndaj lagështisë, korrozionit, etj. dhe të paketohen dhe të trajtohen në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për

ruajtje ne kushtet klimatike te zones per nje periudhe te pacaktuar. Ata do te dorezohen ne barabane celiku te pajisur me etiketa identifikuese ku deklarohet edhe sasia. Percjellesit rezerve do te dorezohen ne magazinat e punedhenesit dhe nuk do te konsiderohen te perfunduar deri sa materiali i paketuar te jete kontrolluar nga perfaqesuesi Punedhenesit.

2.4.1.5 Paketimi, dergimi, transporti

Percjellesat do te dorezohen dhe dergohen ne barabane celiku te mbuluar te vulosur sikurse eshte specifikuar. Paketimi per pjeset reserve korresponduse duhet ti pergjigjet kerkesave per magazinim me kohe te gjate. Te gjitha barabanet me percjelles duhet te kene nje shtrese te papershkueshem nga uji, si leter dylli ose flete plastike e cila duhet te jete e sigurt kunder reaksioneve kimike te percaktuara rreth barabanit te percjellesve dhe nje tjetër hedhur mbi dhe nen spiralet e percjellesve. Barabanet te jene te sigurt dhe te perforcuar mire rreth perimetrit te jashtem, te jene te pershtatshem per transport ne terrene te veshtira dhe per tu rrotulluar ne kembalece pa shkaktuar deme ne OPGW.

Nxjerrja jashte perdorimit e te gjitha barabaneve bosh do te jete pergjegjesi e Kontraktorit.

Informacioni i meposhtem te shkruhet ne menyre te qarte me boje te pa zhdukeshme ne te dy flanxhat ne çdo baraban:

- Titulli i kontrates dhe numri i references;
- Emri i prodhuesit;
- Instruksionet e ngritjes dhe kufizimet;
- Drejtimi i rotullimit.

Nje pllake alumini ose metalike e lyer do te vendoset ne çdo baraban qe tregon ne menyre te qarte te dhenat e meposhtme:

- Tipi dhe permasa;
- Gjatesia;
- Pasha netto dhe bruto;
- Numri i barabanit;
- Data e telezimit;
- Dimensionet kryesore;
- Drejtimi korrekt i rotullimiit.

Kontraktori duhet te paraqese nje skice ose vizatim duke treguar detajet e plota te barabanit. Gjatesia minimale e perçuesit ne baraban eshte subjekt i miratimit te Punedhenesit.

2.4.3 Izolatoret dhe armatura

2.4.3.1 Te pergjithshme

Komplet sasia e izolatoreve perbehet nga qelq i temperuar ne forme kembane si dhe armatura per percjellesit e fazeve dhe trosin OPGW, kerkohen siç pershkruhet me poshte dhe ne par 2.5; **Te dhenat teknike.**

Girlandat e izolatoreve duhet të jenë në përputhje me montimet teknike sipas Anekseve. Montime alternative do të jenë të pranueshme me kusht që ata janë funksionalisht të ngjashme dhe përmbushin specifikimet.

Kontraktori do të sigurojë vizatime të detajuara të izolatoreve dhe armatures të montuara së bashku, të quajtura girlandat e izolatoreve për fiksimin e përcjellesit dhe zinxhret për fiksimin e trosit OPGW .

2.4.3.2 Izoloret dhe Girlandat e izolatoreve

Të gjitha girlandat e izolatoreve përfshirë morsetat dhe pajisje të tyre në mot të mirë nuk duhet të çfaqin kurorë të ndritshme të dukshme . Në veçanti, pjesa metalike e girlandes duhet të konceptohet në mënyrë të tillë që të shmangë shfaqjen e kurorës të dukshme në kohë të mirë.

Pajisjet bllokuese për vetë izolatorin dhe detajet metalike që bashkojnë ato në varg të jenë prej çeliku inox dhe sipas standartit IEC 60372 . Dizajni duhet të jetë i tillë që të lejojë heqjen e lehtë për zëvendësimin e izolatoreve ose detajeve lidhës pa qenë nevoja e shkeputjes së girlandes nga traversa.

Faktoret e pjesëshëm të sigurisë që merren parasysh për llogaritjen e izolatorit dhe girlandes së izolatoreve janë :

- për veprime (ngarkesa), kushte normale $\gamma_F = 1.35$
- për veprime (ngarkesa), kushte të jashtëzakonshme $\gamma_F = 1.00$
- për materiale, izolatore dhe pajisje, kushte normale $\gamma_M = 2.50$
- për materiale, izolatore dhe pajisje, kushte të jashtëzakonshme $\gamma_M = 1.70$

Shtyllat ndërmjetese pajisen me girlanda mbajtëse (varese), ndërsa shtyllat këndore me girlanda tërheqëse duke u përshtatur mbajtjen e përcjellesit sipas EN 50182 .

Hapesira midis vargjeve të dyfishtë të izolatoreve të jenë i mjaftueshëm për të siguruar punim pa probleme të izolatoreve dhe të brirët mbrojtës nga mbitensionet.

Vëmendje e veçantë duhet të tregohet për të siguruar që me demtimin apo keputjen e një vargu izolatorësh në girlandat dyfishtë, vargu i mbetur të përballojë ngarkesën statike dhe dinamike duke aplikuar gjithashtu faktoret e specifikuar të sigurisë të pjesëshme të regulluar me lartësi dhe në fletet e të dhënave teknike.

2.4.3.3 Izolatore prej xhami të temperuar

Standardet

E gjithë seria e standarteve EN dhe IEC e aplikueshme për izolatore tip këmbane do të pranohet për projektimin, prodhimin , testimin dhe shpërndarjen e izolatoreve . Standardet e mëposhtme me të rëndësishme janë përmendur këtu :

- IEC 60305

- IEC 60383
- IEC 60575
- IEC 60120 .

Per me teper njesite e izolatoreve duhet te perputhet me kerkesat e specifikuara ne fletet e te dhenave teknike . Per llojet e ofruara te izolatoreve te dorezohen te dhenat teknike dhe te dhenat statistikore ne lidhje me performacen e tyre.

Kerkesat per prodhuesin e Izolatoreve

Prodhim duhet te kete se paku 15 vjet pervoje ne prodhimin e per izolatore tip kembane dhe duhet te dorezoje referenca furnizimit te blesesve nderkombetare .

Prodhuesi i izolatoreve duhet te jete i certifikuar sipas standardit ISO 9000. Ai duhet te kete nje departament te zhvillimit dhe inxhinierise per te siguruar te dhena teknike edhe pas shitjes si dhe informacion ne lidhje me izolatoret.

Çdo izolator do te marketohet me informacionin e meposhtem :

- Emri i prodhuesit ose logo
- Viti i prodhimitt
- Ngarkesa minimale mekanike e shkaterrimit
- Kodi identifikues qe siguron gjurmueshmerine .

2.4.3.4 Morsetat dhe armatura per percjellesit

Morsetat dhe armatura duhet te jene ne perputhje me kerkesat e pershkruara ne vijim dhe ne listat e te dhenave teknike dhe duhet te miratohen nga Punedhenesi.

Morsetat duhet te jene te pershtatshem per percjellesin.

Te gjitha morset dhe pajisjet pervec qetesuesve duhet te furnizohen nga i njejti prodhues. Nuk do te lejohet ndarja e furnizimit te morsetave nga armatura (pjesa tjeter e detajeve metalike te girlandes se izolatoreve).

Te gjitha pjeset e hekurit te elementeve perberese te girlandave te izolatoreve duhet te jete e galvanizuar ne thellesi ne te nxehte sipas ISO 1461. Kunji i te gjitha morsetave dhe pjeseve te tjera te armatures te jene prej çeliku inox .

Shufra mbrojtese

Shufra mbrojtese aliazh alumuni do te perdoret per te mbrojtur percjellesit fazor ne morsetat mbajtese.

Morsetat mbajtese per percjellesit fazor te pershtaten per diameter me te madh se percjellesi qe shkaktohet nga vendosja e shufrave mbrojtese.

Skajet e shufrave mbrojtese, rrumbullakosen mire, pa tehe te mprehta, per te shmangur nje shfaqje te mundeshme te efektit kurore.

Drejtimi i thurjes së shufrave mbrojtëse duhet të jetë e njëjta me atë të përcjellesit.

2.4.4 Qetesuesit

2.4.4.1 Kerkesat

Morsetat e demferit duhet të jenë aliazh alumini dhe duhet të jenë projektuar në mënyrë të tillë që të mos shkaktojnë dëmtime në përcjellesin OPGW.

Persa i përket bullonave të morsetave, ato duhet të jenë prej çeliku me qëndrueshmëri minimale prej 800 N/mm^2 . Rrondet duhet të jenë prej çeliku inoksidabel.

Elastomeret ose materialet e tjera jo metalike duhet të kenë rezistencë të mirë kundër vjetërimit dhe duhet të jenë të afta të durojnë ndryshimin e temperaturës nga -20°C në $+75^\circ\text{C}$ pa ndryshuar vetitë e tyre kryesore. Materialet duhet të kenë veti të përshtatshme për të rezistuar efektet e ozonit, rrezatimit ultra-violet dhe ndotjes së ajrit.

2.4.5 Ndertimi, terheqja e përcjellesve, komisionimi

2.4.5.1 Te përgjithshme

Pjesa në vijim e dokumentave të tenderit përmban kërkesat dhe kushtet për zhvillimin e aktivitetit në kantiër, si përgatitja e rrugëve ndihmëse, pastrimi i trasës, piktimi i shtyllave, përgatitja e vendndodhjes së shtyllave, punimet e bazamenteve, mbrojtja nga erozioni, ngritja e shtyllave, tendosja e përcjellesave dhe OPGW, si dhe komisionimi.

Kontraktori duhet të hartojë një plan të përshtatshëm, dhe duhet të copezojë gjatësinë e linjës në seksione të përshtatshme, të cilat duhet të atakohen me vete dhe në mënyrë të njëkohshme, në mënyrë që të kapet afati i përfundimit të parashikuar në kontratë. Për të garantuar këtë për secilin seksion duhet të parashikohet një skuadër e veçantë, me numrin e mjaftueshëm, të punonjësve për të garantuar mbylljen në kohë të punimeve.

Kontraktori duhet të sigurojë numrin e nevojshëm të supervizoreve në kantiër, për të mbikëqyrur në mënyrë të vijueshme të gjitha punimet për kompletimin e linjës, me qëllim garantimin e cilësisë së kërkuar në dokumentat e tenderit.

2.4.5.2 Siguria dhe supervizioni

Kontraktori duhet të përgatisë një raport lidhur me sigurinë në punë, në përputhje me kërkesat lokale për këtë qëllim, dhe ta dorëzojë për miratim Punedhësit.

Siguria e personelit.

Metodat e kryerjes së punëve dhe kualifikimi i personelit, duhet të përputhen me kërkesat e standarteve të cilësisë me të lartë. Në të gjitha aspektet, kërkesat e pranuar gjëresisht,

si dhe praktikat puneve të cilesise se mire, do të jenë vazhdimisht të mbikqyrura. Punedhenesi duhet të mbetet i kenaqur nga cilesia e puneve të kryera dhe duhet të konfirmojë këto. Sidoqoftë konfirmimi i Punedhenesit për punë me cilësi të mirë nuk do të çlirojë kontraktorin nga përgjegjësitë dhe detyrimet e tij. Kontrata punë, me maksimumin e sigurisë, në linjë me praktikën e mirë të ndërtimit dhe montimit, duhet të akordohet personelit të angazhuar me kryerjen e punimeve.

Kjo u referohet punonjesve për germimin e bazamenteve, veçanërisht ato që do të përdorin eksploziv për germimet, si dhe punonjesve të montimit të shtyllave.

Kujdes i veçantë duhet të aplikohet gjatë ngritjes së shtyllave, punonjesit që nuk do të angazhohen në procesin e ngritjes duhet të spostohen në një zonë të sigurtë.

Duke qenë se ndërtimi dhe montimi i linjës në disa zona do të bëhet në zona ku ka linja ekzistuese, nën tension, do të merren masa shtesë për të siguruar mbrojtjen e punonjesve nga tensionet e induktuara. Këto masa duhet të sigurohen gjatë montimit të përcjellesave dhe trosit OPGW.

Të gjitha punimet e montimit të përcjellesave dhe kablove në zonat e rezikshme do të kryhen nën mbikqyrje të rrepta në përputhje me "Rregullat e punimeve me përcjelles dhe kablo në afërsi të linjave të TN me tension"

Masat shtesë në punimet që kryhen në kryqezim me objekte të ndryshme konsistojnë si më poshtë:

1) Kryqezim me rruget:

- Koha e fillimit, kohezgjatja, dhe teknologjia për të garantuar sigurinë e punimeve të shtrirjes dhe tërheqjes së përcjellesave në kryqezim me rruget, duhet të bëhen dakort me entet që më merren me administrimin e këtyre rrugëve.
- Gjatë kohës së kryerjes së punimeve, prezencë e përfaqësuesve të këtyre enteve është e nevojshme;
- Në vendet me trafik, përcjellesit duhet të jenë në lartësi jo më të vogël se 6 m;
- Në momentin e shtrirjes së përcjellesave duhet të ndërpritet trafiku;
- Në të dy anët e kampatës që shtrihet teli, në distancën 100 m, kryepunëtori duhet të nxjerrë njëzë me flamuj paralajmërues, të cilët në rastin kur është e nevojshme duhet të pezullojnë trafikun;
- Vendi i punës duhet të markohet me shenja paralajmëruese;
- Shtrirja e përcjellesave nuk duhet të kryhet në kohë me mjegull, me shikim të kufizuar, në mot me ngrica, dhe në mot me erë më të fortë se 10 m/s.

2) Kryqezimi me linjat e nderlidhjes:

- Teknologjia e shtrirjes në kushte sigurie të përcjellesave në kryqezim me linjat e nderlidhjes do të bëhet në marrëveshje me ndërmarrjet që administrojnë këto linja;
- Shtrirja e telave në kryqezim me linjat e nderlidhjes bëhet vetëm kundërshtimisht me shkrim të administratoreve të këtyre linjave.
- Masat e sigurisë për mbrojtjen e linjave ajrore e kablove të nderlidhjes nga shkarkimet atmosferike do të bëhen në marrëveshje me administratoret e këtyre linjave. Montimi

i percjellesave ne kryqezim me linjat e nderlidhjes mund te behet vetem mbas kompletimit te masave te parashikuara ne vizatimet e veçanta per kryqezimin e linjes me linjat ne fjale, vizatime keto qe duhet te kene marre miratimin e pronarit/administratorit te linjes se komunikimit, dhe shtrirja e percjellesave duhet bere ne prezence te perfaqesuesve te linjave te komunikimit;

- Masat per parandalimin e rrezikut dhe te zhurmave nga efekti i linjes ne ndertim per llogari te kesaj kontrate, duhet te behen ne marreveshje me administratoret e linjave te nderlidhjes.
- 3) Kryqezimi me linja ekzistuese te transmetimit:
- Perpara marrjes se lejes per te punuar, personeli i kontraktorit do te instruktohet nga personeli pergjegjes i shfrytezimit te ketyre linjave, personeli i kontraktorit do te instruktohet per masat parandaluese te sigurise, ne vendin e punes. Instruktimi do te behet nga personeli qe ka kompetence per te leshuar lejen e kryerjes se punimeve;
 - Perpara shtrirjes se percjellesit dhe OPGW, te gjitha shtyllat ankerore ku ne vizatim eshte parashikuar tokezimi, duhet te tokezohen ne perputhje me vizatimin;
 - Montimi i percjellesave do te behet vetem pasi te jete stakuar linja ne tension dhe te jete tokezuar ne te dy skajet kampata qe kryqezohet me linjen ne ndertim. Per te siguruar kete , personeli administrativ i linjes ne tension, do te deshmoje kryepunetorit te grupit te montimit heqjen e tensionit, nepermjet tregimit te fijes se tokezuesit portativ ne te dy skajet e kampates;
 - Te gjitha punimet do te kryhen ne prezence te perfaqesuesit te linjes ne shfrytezim;
 - Zona e punes do te markohet nepermjet mjeteve sinjalizuese te paralajmerimit per personelin dhe trafikun.

Perputhshmeria me rregullat dhe rregulloret

Te gjitha pajisjet dhe materialet e furnizuara si dhe te gjitha punimet e kryera duhet te perputhen ne te gjitha aspektet me kerkesat dhe rregullat e rregulloret si dhe aktet ne fuqi ne vendin e Punedhenesit dhe qe aplikohen per kontratat e punimeve.

Garancite e pergjithshme dhe te veçanta

Punimet duhet te plotesojne te gjitha veçorite dhe garancite e kerkuara ne dokumentin e kontrates.

Te gjitha metodat e punes dhe impiantet e pajisjet e furnizuara ne zbatim te kesaj kontrate, duhet te miratohen nga punedhenesi.

Kontraktori do te jete pergjegjes per çdo devijim, gabim, ose mungese ne lidhje me garancite e pergjithshme dhe te veçata te percaktuara ne kontrate.

Akomodimi

Kontraktori do te jete vete pergjegjes per akomodimin e stafit te ardhur nga jashte apo te rekrutuar lokalisht ne vend per kryerjen e punimeve. Te gjitha strehimet dhe godinat e ngritura nga kontraktori per akomodimin e punonjesve duhet te jene ne perputhje me te gjitha rregullat ne fuqi ne vendin e Punedhenesit.

Kampuset e perkoheshme te ngritura nga kontraktori duhet te jene te kompletuara me te gjitha nyjet sanitare si dhe facilitetet e tjera te domosdoshme. I gjithë akomodimi do te zmontohet nga kontraktori kur nuk do te nevojitet me. Pas zmontimit terreni duhet te pastrohet dhe dorezohet i rehabilituar.

Sherbimi mjekesor

Kontraktori duhet ta rregulloje vete sigurimin e sherbimit shendetesor qe mund tu nevojitet punonjesve te tij.

Transporti i stafit

Kontraktori do te siguroje me shpenzimet e tij te gjithë transportin e nevojshem per personelin dhe materialet.

Zyrat

Kontraktori duhet ti siguroje vete godinat qe nevojiten per zyra. Kostoja per sistemin e personelit te kontraktorit ne zyra konsiderohet e pershire ne çmimin e kontrates.

Magazinat

Kontraktori do te siguroje vete distancat elektriket e nevojshme per magazinim, dhe duhet te marre miratimin e Punedhenesit per zonat per gjate linjes ku ai mendon te beje magazinim materialesh dhe pajisjesh. Keto vende nuk duhet te ndodhen jashte zones se autorizuar, me perjashtim te rasteve kur kontraktori ben marreveshje te vlefshme legalisht me pronaret e tokes. Kontraktori do te siguroje vete mbrojtjen dhe ruajtjen e materialeve te stokuara nga ai. Administrimi dhe magazinimi i çdo paisje ne kantier do te jete ne risk te kontraktorit dhe punedhenesi perjashtohet nga çdo lloj pergjegjesie. Kontraktori duhet te siguroje mbrojtjen e materialeve nga korrodimi dhe demtimi mekanik gjate magazinimit.

Magazinimi ne kantier duhet te pregatitet me kujdes, me vendosjen korrekte te barabaneve te telit, elementeve te shtyllave, izolatoreve dhe morseterive, ne menyre qe materialet te mos demtohen gjate situatave te renda klimatike. Materialet e djegeshme duhet te magazinohen ne menyre te tille qe te evitohet rreziku nga zjarri.

Kapacitetet ngritese

Kontraktori do ti siguroje vete vinçat apo mjetet e tjera ngritese.

Pergjegjesia e kontraktorit

Nese punedhenesi provon se kontraktori nuk eshte i afte te kompletoje qofte dhe nje seksion te linjes ne afatin e percaktuar ne plan, atehere kontraktori duhet te oganizojë punen ne kete seksion tej orarit normal te punes, ky angazhim nuk i jep te drejten kontraktorit te pretendoj per asnje rrites kostoje te punimeve.

Nese punedhenesi do te çertifikoje se gjate punes jane shfaqur defekte te punimeve, kontraktori eshte i detyruar te mbaje ne kantier personelin e nevojshem per eliminimin e ketyre difekteve pershire dhe personelin e supervizionit.

Perderisa çdo seksion të jete mare ne dorezim, ne perputhje me kushtet e kontrates, kontraktori do të jete krejtësisht pergjegjes per seksionin ne ndertim apo ne testim. Gjate periudhes se mirembajtjes kontraktori do të siguroje qe nje perfaqesues i tij kompetent do të jete disponibel ne kantier, me qellim qe të marre persiper kryerjen e çdo pune apo riparimi per të cilen kontraktori eshte pergjegjes.

Çdo pune, e cila do të jete domosdoshme të kryhet si detyrim i kushteve të kesaj kontrate, do kryhet ne menyre të tille qe të preke sa me pak funksionimin e rregullt të sistemit energjistik. Punet do kryhen gjate atyre orareve qe punedhesi do të kerkoje.

Punimet të cilat janë treguar ne vizatime por nuk janë permendur apo pershkruar ne kerkesat teknike, apo janë treguar ne kerkesat teknike por nuk janë paraqitur ne vizatime gjithmone do të konsiderohen të perfshira ne kontrate dhe detyrimisht do kryhen nga kontraktori brenda çmimit të kontrates

Te punesuarit e kontraktorit

Kontraktori do të kujdeset per plotesimin e detyrimeve ndaj të punesuarve të tij ne perputhje me kerkesat e kontrates dhe legjislacionit Shqiptar.

Kontraktori do të jete pergjegjes per sjelljen, gjate orarit të punes, të personelit të punesuar prej tij.

2.4.5.3 Pastrimi i trasese

Pastrimi i trasese se linjes eshte detyre e Kontraktorit
Kontraktori do të njoftoje ne menyren e duhur pronarin e tokes per fillimin e punimeve të pastrimit.

Spastrimi i pengesave

Per të eliminuar rrezikun e zjarrit shkurret dhe pemet veçanerisht, pishat duhet të priten nga korridori i linjes. Gjate spastrimit të trasese nga pemet dhe shkurret, kerkesat e meposhtme duhen plotesuar:

Pemet frutore dhe të korrat nuk duhen prere gjate procesit të pastrimit të korridorit të linjes. Kontraktori duhet të beje kujdesin e duhur per të menjanuar demtimin e ketyre pemeve frutore. Kompensimi per çdo demtim të ketyre pemeve frutore, demtim i cili sipas opinionit të Punedhesisit nuk eshte i domosdoshem per krijimin e kushteve per kryerjen e punimeve, do të perballohet nga kontraktori. Pemet e tjera dhe shkurret duhet të priten sipas normave shiptare të projektimit.

Kontraktori duhet të marre të gjitha masat qe gjate prerjes se pemeve ne afersi të godinave apo infrastruktures publike, si dhe pronave private të beje largimin e menjehereshem pas prerjes, dhe ne rast të demtimit të njerit nga facilitetet e permendura me sipër, kontraktori duhet të beje çdemtimin e subjektit.

Lejet e nevojshme per heqjen e pengesave per ndertimin e linjes të paraqitura nga gardhe, godina, infrastrukture etj. do të sigurohen nga punedheshi.

Ripastrimi

Perpara leshimit të çertifikates paraprake të pranimit, ose në kohën e rene në marrëveshje me punëdhënësin, kontraktori duhet të ribejë riprërijën e pemeve dhe shkurreve në lartësinë standarte të kërkuar në këto kontrate.

Kryqezimi me pengesat

Kontraktori, me shpenzimet e tij duhet të bëjë të gjitha rregullimet e nevojshme kur linja kryqezohet me godina, linja nderlidhje, linja fuqie, kopeshte, hekurudha, rrugë, apo në përgjithësi kur punimet e montimit të linjës nuk mund të bëhen normalisht si në tokë djerre, por kërkojnë masë shtesë për kryerjen e tyre.

Rregullimet e nevojshme të mbështetura me kalkulimet perkatese, duhet të paraqiten me vizatime të veçanta për çdo kryqezim, dhe këto vizatime duhen miratuar nga punëdhënësi.

Kontraktori duhet të sigurojë të gjitha skelat për kryqezimin me linjat e telekomunikacionit ose të fuqisë, rrugëve etj. Kontraktori duhet të keshillohet me punëdhënësin për çdo skeler që planifikon të perdore.

2.4.5.4 Shtrirja dhe terheqja e percjellsave

Trajtimi dhe magazinimi

Në magazinim dhe gjatë përdorimit, të gjitha percjellesat dhe bobinat duhen mbajtur lart nga toka dhe në një ambient të pastër. Duhet shmangur të gjitha kontaktet me të gjithë substancat të cilat mund të demtojnë materialet dhe bobinat. Percjellesat dhe OPGW nuk duhen preplasur në tokë apo në sipërfaqe të forta.

Duhet marrë masë për shmangien e rënies së bobinave në tokë gjatë kohës kur ato shkarkohen nga automjetet transportuese.

Plani për shtrirjen e percjellsave

Të pakten një muaj para se të fillojë shtrimi i percjellsave, kontraktori duhet të marrë në konsideratë të gjithë faktorët që do të përfshihen dhe duhet të paraqisë ata para Inxhinierit për miratim, një propozim për afatin e shtrirjes së percjellsave, i cili jep vendndodhjen e percjellsave tokëzimin, pozicionin e propozuar, së bashku me vendndodhjen e shtyllave si dhe të gjithë informacionin e kërkuar për shtrirjen e percjellsave duke përfshirë edhe tensionin maksimal i cili do të përdoret gjatë funksionimit të lidhjeve pilot.

Mjetet dhe aparaturat

Mjetet dhe aparaturat do të jenë konform Standardeve IEEE 524, Guida për instalimin e Percjellsave të Linjave të Transmetimit si dhe kushteve që janë përkrahur si më poshtë.

Mberthimi i blloqeve

Mberthimi i blloqeve do të projektohet për shtrimin e percjellsave dhe do të ketë format, kalibrat dhe permasat në përputhje me Standardet IEEE 524. , rrotullat do të jenë të pajisura me mjete mbrojtëse dhe do të jenë të mbuluara me materiale të gomuar të cilat do të jenë të miratuara nga Inxhinieri. Rrotullat që do të përdoren për instalimin e çelikut të galvanizuar në një terren duhet të ndahen me vete. Këto rrotulla nëse do të duhen, do të

jene te perbera nga nje shtrese alumini, dhe kalibrat do te kene nje rifiniture te bute dhe te lustruar.

Rrotullat duhet te kene nje levizje te lire dhe te lehte si dhe nuk duhet te shkaktojne deme ne siperfaqet ku jane percjellesat. Rrotullat te cilat nuk funksionojne normalisht dhe qe gjate punes nuk japin rezultat, duhen zevendesuar menjehere.

Pozicioni i bobinave

Pozicioni i bobinave duhet te ndertohet mire dhe duhen vendosur edhe ndalesa per keto bobina ne menyre qe te mos levizin. Ndalimi i levizjes se percjellesave duhet kontrolluar ne menyre positive dhe duhet kryer ne nje menyre e cila duhet te shmange te gjitha demet qe mund te shkaktohen.

Kontraktori duhet te jete pergjegjes per pastrimin e te gjitha pjeseve (rreth 2m te gjere) gjate linjes qendrore

Terheqesi i fuqishem

Terheqesi i fuqishem duhet te kete nje kapacitet jo me pak se maksimumi i tensionit te percjellesave. Sistemi terheqes duhet te kete nje çikrik te fuqishem me mekanizma transmetues per ndryshimin e shpejtesise gjate punes per shtrirjen e percjellsave.

Pajisjet per tensionin e shtrimit te percjellsave

Pajisjet per tensionin e shtrimit te percjellsave do te jene prej Tefloni. Frenat e kontrollit do te projektohen ne ate menyre qe te arrihet tensioni maksimal, dhe ky tension do te mbahet konstant aq sa te punojne frenat. Diametri i rrotave dhe materialet shoqeruese duhet te miratohen nga Punedhenesi. Materialet Neoprene apo Teflon mund te jene te pranueshme vetem nese jane prej te pakten 6 mm te trasha.

Shtrimi

Shtrimi do te behet ne ate lloj qe te instalohet kudo mbi percjellesa dhe te rezistoje kur te rritet tensioni neper percjellsa. Çdo lloj shtrimi tjetër, nese do te kerkohej, duhet te miratohet nga inxhinieri.

Kompresoret per Bashkimet dhe Fundet e konektoreve

Ne kete rast do te perdoren kompresore me ajer te pajisur me mekanizma shtytjeje si dhe tipet e tjera te miratuara, do te perdoren per kaliomine tensionit. Kjo ne nje fare menyre duhet te plotesoje kerkesat per plotesimin e percjellesave.

Meter gjatesie.

Eshte i nevojshem nje meter gjatesie per matjen e percjellsave apo OPGW-se gjate shtrimit te tyre dhe kjo mund te jete pjese e terheqesit te fuqishem apo te pajisjeve te tensionit te percjellsave.

Kryqezimi i rrugeve, linjat e tensionit, etj

Skelat duhet të vendosen sipër rrugëve, linjave të tensionit apo atyre të komunikimit, shtepive etj. Shpenzimet për skelat duhet të përfshihen në çmimin e shtrirjes së përcjellesave.

Skelat që do të përdoren për kalimin e linjave me tension të ulët, mesëm apo të lartë duhet të jenë të atij dimensionit dhe të bëjnë të mundur që linjat të jenë në funksion gjatë ndërtimit të linjave të reja të transmetimit. Linjat që do të mbikalohen mund të stakohen për ndërtimin e linjave të reja por nuk mund të stakohen në mënyrë të vazhdueshme për periudha të gjata. Këto punime në ndërtimin apo përdorimin e skelave nuk duhen bërë shkas për të shtuar shpenzimet. Projektimi dhe ndërtimi i skelave nuk duhet të jetë inferior për standardet minimale të përcaktuara më poshtë.

Skelat duhet të projektohen në atë mënyrë që të durojnë shpejtesinë maksimale të erës, apo rënien e përcjellesit nga lart. Skela konsiston në lidhje litare nayloni të bashkuar me litare të gjatë çeliku të cilat do të formojnë një rrjetë metalike me intervale prej 3 m. Normalisht mund të përdoren dhe skelat e çelikut apo atë aluminit.

Struktura e skelave duhet të jetë sipas kërkesave të sigurisë duke pasur parasysh mundësinë aksidenteve që mund të shkaktohen nga kontakti me përcjelleset gjatë ndërtimit, përdorimit apo heqjes së tyre.

Skelat së bashku me bazamentin do të projektohen dhe do të ndërtohen për të garantuar stabilitet gjatë projektit të ngritjes dhe heqjes së tyre, gjithashtu edhe gjatë kohës kur puna ka ngecur për arsye të ndryshme duke përfshirë edhe kushtet e kohës. Bazamenti duhet të jetë i përshtatshëm për truallin e menduar. Skela duhet të shtrihet të pakten 2m në distancë. Kapeset do të jenë në fund të çdo mbështetëseje të skeles. Kapeset do të jenë vertikale në një kënd prej 45 gradesh.

Ato duhet të jenë të afta të mbajnë ngarkesën e specifikuar pa shkaktuar probleme gjatë kohës kur kryhet shtrirja e përcjellesave.

Pjesët e sipërme të skelave do të ndërtohen me materiale të buta gome, në mënyrë që të parandalohet demë gjatë kohës kur përcjellesat do të jenë sipër tyre. Për këtë qëllim mund të përdoren pole të buta druri. Gjatesia e këtyre pjesëve do të jetë e mjaftueshme për të parandaluar që përcjellesi të demtojë rrjetin e nailonit. Për të evituar demtimin e përcjellesit, sipër këtyre pjesëve mbrojtëse nuk duhet vendosur asnjë lloj materiali i cili mund të demtojë ato.

Skelat duhet të ndërtohen për të parandaluar hyrjen e pa autorizuar apo ngjitjen në to të personave të panjohur për inxhinierin. Skelat do të pajisen me llampa të kuqe gjatë natës, nëse janë ngritur 2 m larg një hekurudhe apo një rrugë kembesoresh dhe nuk janë të mbrojtura me gardh.

Mundësisht skelat të jenë me pak se 10 ohm. Një konsideratë speciale nga inxhinieri i duhet dhënë rasteve kur skelat nuk janë në përputhje me togezimin. Lidhja e skeles me sistemin e togezimit nuk është normalisht i pranueshëm. Në ndonjë rast të njëjtit defekt i linjës mund të shkaktojë demë.

Mund të ndodhë ndonjë defekt midis linjave, shufrat e togezimit duhet të futen nën tokë përafërsisht 1 m nga struktura e skeles. Shufrat duhen lidhur me siguri elektrike dhe mekanike me strukturën e skeles me një mbulesë fleksibel alumini me një zonë minimale kryqë respektivisht 64 mm² dhe 100 mm².

Nje skice e skeles, e kompletuar me detajet, dhe detajet e togezimit se bashku me perlllogaritjet duhet ti paraqiten Inxhinierit per miratim.

Ne pjesen Malazeze te linjave, te gjitha linjat e e tensionit te ulet, te cilat kryqezohen duhet te pajisen me kabell ne kete seksion. Linjat duhet te raportohen tek Inxhinieri dhe duhen ndjekur instruksionet e tij per rindertim.

Lidhja e percjelleseve

Lidhja e percjelleseve duhet te behet teresisht me metodat e lidhjes me tension dhe Kontraktori duhet te paraqese per aprovim hollesi te plote te nje metode te sakte te lidhjes me tendosje dhe te pajisjeve lidhese qe synohet te perdoren. Percjellesat duhet te mbahen larg tokes sa here qe ato jane ne levizje. Metoda e lidhjes me tendosje qe kerkohet per instalimin e te gjithe percjellesave do te kontrollohet ne menyre te vazhdueshme.

Dy percjellesat qe formojne tufen e seciles faze duhet te instalohen ne te njejten kohe dhe duhet te mbahen ne te njejten tendosje gjate gjithe punes.

Lidhja e percjelleseve, ne asnje rast, nuk duhet te behet deri ne 28 dite pasi eshte vendosur themeli i betonit ose ne nje kohe tjeter te aprovuar nga perfaqesuesi i sipermarresit ne varesi te llojit te betonit te perdorur dhe kushtet lokale dhe kur nuk jane mbledhur dhe ngjeshur akoma lidheset e struktures dhe kur nuk jane shtrenguar e kontrolluar plotesisht nga perfaqesuesi i sipermarresit.

Duhet t'u behet perdorimi maksimal i gjithe gjatesive te percjelleseve ne menyre qe te reduktohet numri i bashkuesve ne minimum. Numri dhe vendi i bashkuesave me tendosje te percjellesit duhet te jete i aprovuar. Bashkuesit me tendosje nuk duhet te jene me pak se 30m te gjate nga shtrenguesja me e afert e percjellesit.

Kontraktori duhet t'i kushtoje kujdes te vecante qe percjellesat te mos zvarriten ne toke asnjehere dhe gjate ngritjes te mos hyjne ne kontakt me ndonje pengese te tille si mure, gardhe ose ndertesa, etj.

Rrotullat e percjellesit duhet te shqyrtohen me kujdes para se te terhiqen si dhe gjithe gozhdet ose ndonje gje tjeter, qe mund te demtoje percjellesin, duhet te hiqen. Gjate lidhjeve, rrotullat e percjellesit duhet te kontrollohen ne çdo kohe dhe percjellesi duhet te kontrollohet per defekte gjate terheqjes nga rrotullat. Rojtaret duhet te pozicionohen ne vendet kritike te struktures per te siguruar proceset e lidhjes pa probleme.

Tendosja e percjellesit gjate veprimeve lidhese duhet te jete mundesisht sa me e vogel, e qendrueshme qe t'i mbaje percjellesit ne nje distance te sigurte larg tokes gjate levizjes. Asnjehere nuk lejohet tendosja me teper se 75% e tendosjes perfundimtare.

Te gjitha pajisjet lidhese duhet te vendosen si duhet the te pozicionohen ne menyre te tille qe shtyllat dhe pajisjet te mos mbingarkohen. Bobinat e percjellesave duhet te sigurohen mire gjate lidhjeve dhe kriku i çdo bobine duhet te jete ne menyre te tille qe te vet-frenoje per te parandaluar levizjen tej mase te percjellesave. Pajisja qe ben terheqjen e OPGW duhet te jete e tille qe te siguroje nje terheqje te qendrueshme e te vazhdueshme. Duhet

te merren masa për të parandaluar demtimin e përcjellesave. Mashat dhe mekanizmat e tjere të nevojshëm për manovrimin e përcjelleseve gjatë ngritjes nuk lejojnë rreshqitje ose levizje të vogla të skajeve ose shtresave dhe nuk mund të deformohen apo shtremberohen përcjelleset.

Tokezimi i përcjellesave, OPGW dhe pajisjeve lidhese

Përcjelleset dhe OPGW duhet të tokezohen si duhet dhe në një mënyrë të aprovuar gjatë levizjes në të gjitha vendet ku punohet me to.

Tokezimi i mjaftueshëm e mban të sigurtë dhe e ruan deri në momentin që do të hiqet prej aty. Pozicioni i tokezimit duhet të regjistrohet nga Kontraktori.

Fijet e përcjellesit me neopren dhe gome kanë një kalim elektrik midis pikave të kapjes dhe përcjellesit ose OPGW të mbështetur brenda tyre dhe kështu do të levizë me ferkimin minimal.

Gjatë operacioneve të lidhjes, kur këto kryhen në afërsi ose terthor të linjave me energji, Kontraktori duhet të marrë masat e nevojshme për parandalimin e aksidenteve dhe demtimeve të personave dhe pajisjeve për shkak të induksionit ose kontaktit fizik.

Seksioni kryesor që mbron punëtoret kundër rrymës elektrike i induktuar nga një linjë transmetimi e energjise përben një tokezim të besueshëm të përcjellesave dhe çdo seksioni të linjës në teresi dhe menjëherë në vendet ku po bëhen punimet e instalimit:

- Për heqjen e përcjellesit në çdo karrukull, ajo duhet të tokezohet:
- 1) Në një mekanizëm të palevizshëm – duke bashkuar pjesën e majtë fundore të përcjellesit në karrukull përmes shtyrjes së rrotullës dhe rullit të shtyllës e tokezimit ose përcjellesi i levizshëm me tokezim;
- 2) Në një baraban të levizshëm – duke bashkuar pjesën fundore të përcjellesit të fiksuar të përcjellesi me tokezim.

Gjatë përgatitjes së rrotullave me përcjellese për ndares, gjithë punimet që lidhen me kontaktin e përcjellesit deri në momentin e tokezimit të pjesëve të tyre fundore do të bëhet duke përdorur doreza elektrike.

Kur bëhet një ndarje, përcjellesi duhet të tokezohet sa herë që varet në shtyllë me ndares ose izolues.

Kur këto punime kryhen nga një vinç teleskopik, për të barazuar potencialet e platformës së punës (koshin) e shtyllës, para varjes së përcjellesit do të lidhet me një përcjelle të tokezuar të levizshëm me këte përcjelle. Baza e një vinçi teleskopik mbi një kamion do të lidhet përpara me qarkun e tokezimit të shtyllës ose të përcjellesit të levizshëm të tokezuar.

Të gjithë punimet në tokë në instalimin e përcjellesit në rrotullën ndarese bëhen duke përdorur doreza dielektrike, ose tokezimi bëhet menjëherë afër vendit ku kryhet puna.

- Pasi rrotulla ndarese me përcjellesin varet mbi shtyllë, tokezimi duhet të hiqet për t'u përdorur për fazën ose shtyllën tjetër.

- Pas kompletimit të këtij veçuesi, percjellesi duhet të tokezohej në vend. 5-6 kthesat e fundit të percjellesit do të hiqen nga rrotullat me dorë duke përdorur doreza dielektrike.
- Kur percjellesat lidhen në kanalet e linjave me një nga metodat (reduktim, ngjeshje e mashave lidhese), të dy fundet e percjellesave do të jenë me percjelles të levizshëm me tokezim të bashkuar me secilin percjelles të perkohshëm ose të perhershëm (qarku i tokezimit të shtyllës) të instaluar menjëherë afër vendit ku kryhet puna.

Gjithë punimet në lidhjen e percjellesave mund të kryhen vetëm brenda zonës së një rrethi me rreze 3 m nga vendi i instalimit të perkohshëm të percjellesit me tokezim. Punimet për lidhjen e percjellesave mund të kryhen gjithashtu në një platforme metalike e lidhur me percjellesat e levizshëm me tokezim në të dy fundet e percjellesit ose telit të kabllit. Percjellesat me tokezim mund të instalohen në percjellesat vetëm duke përdorur shufra izoluese.

Ndarja e grupit tjetër të rrotullave mund të bëhet në të njëjtën mënyrë me tokezimin e percjellesave individuale (tela kabujsh).

Para lidhjes dhe perkuljes të gjithë percjellesat duhet të tokezohej në të dy shtyllat në kufijtë e vendit të instalimit. Në fillim të vendit duhet të tokezohej një rull (bllok), përmes të cilit kryhet lidhja e percjellesit, ndërsa në fund të vendit tokezimi është në një grup të ngritur.

Percjellesi i tërhequr poshtë për mbylljen e kapesës tendosese do të tokezohej djathtas në vendin e mbylljes.

Kunjat e shtyllave duhet të ngjiten vetëm pasi janë kryer gjithë punimet e montimit. Pas fiksimit të percjelleseve me fije izoluese të tendosura në terminalët metalikë të shtyllës, percjellesat duhet të tokezohej duke i ngjitur ato në shtyllë tërthor me percjellesat e levizshëm me tokezim.

Percjellesat e tokezuara mbeten në percjellesa derisa të kryhet montimi i këtij OHTL.

Para se të vihen nga rrotullat veçuese në mashën mbajtëse dhe para instalimit të kllapës vibruese, secili percjelles do të tokezohej për kohën e kryerjes së punimeve, si më poshtë:

Instalimi i distanciatoreve nga toka duhet të bëhet duke lidhur me përpara të gjithë percjelleset e fazës të percjellesi të levizshëm me tokezim ose lidhja e një prej percjellesave të fazës në rastin kur percjellesat sapo janë levizur nga çengelët ndares në mashat mbajtëse jo më tepër se 50 m nga vendi i punës ose kur grupi i meparshëm i distanciatoreve i këtij harku sapo është instaluar. Kur këto punime kryhen nga një vinç teleskopik, percjelleset me tokezim duhet të instalohen në të njëjtën mënyrë sikurse distanciatorët instalohen nga toka të të gjithë ose të një percjellesi të fazës.

Kur punimet me percjellesat kryhen dhe kllapat me vibracion dhe distanciatorët janë instaluar në seksionin OHTL sipas konstruksionit, percjellesat me tokezim në pjesën fundore të shtyllës që ngelen të bashkuara me percjellesat duhet të hiqen.

Tokezimi i percjellesave në seksionin e perfunduara OHTL do të mbetet vetëm në fillim të këtij seksioni.

Berryllat e percjellesave ne kunjat e prere ne shtyllat me kend-tendosje do te lidhen sipas kesaj radhe;

- Percjellesat e levizshem me tokezim do te vihen ne piken e tokezimit te telit ose ne krahun terthor te shtylles dhe ne te dy fundet e telave te kabujve, dhe telat e kabujve do te bashkohen me shtyllen sipas ndertimit te saj;
- Pastaj keto percjellesa me tokezim, do te levizen ne krahun terthor te shtylles dhe percjellesave, dhe percjellesat duhet te lidhen me kunjat sipas ndertimit;
- Meqenese kunjat lidhen me shtyllat me vendosje me kend, e fundit e te gjithave do te hiqet ne percjelleset me tokezim te mbetur ne percjelleset ne fillim te secilit seksion OHTL.

Do te perdoren si percjellese tokezimi si me poshte:

- Ne te maje te shtylles – krahu terthor i shtylles metalike;
- Ne fund te shtylles – percjellesat me tokezim te shtylles se nje ndertimi dhe tipi.

Percjellesat e levizshem me tokezim bashkohen me trupin e shtylles ne nje vend te pastruar nga boja. Per tokezimin e percjellesave (tela kabujsh), duhet te perdoren mekanizma te projektuar posaçerisht – shufra izoluese dhe percjellesa te levizshem me tokezim me tel bakri fleksibel me madhesi te pakten 25 mm², me shtrenguese.

Percjellesat e levizshem me tokezim duhet te vendosen dhe te fiksohen sipas ketij rendi:

- Percjellesat me tokezim do te lidhen me ane te nje shtrenguese te teli i tokezimit (tokezim);
- Pastaj me nje shufer izoluese percjellesi me tokezim do te vendoset ne nje percjelles (tela kabujsh).

Heqja e percjellesave te levizshem me tokezim do te behet sipas nje rendi te anasjellte: se pari percjellesi me tokezim do te hiqet nga percjellesi duke perdorur nje shufer izoluese dhe pastaj stakohet nga teli i tokezimit.

Para montimit te percjellesave dhe telave te kabujve, te gjitha shtyllat e seksionit ne konstruksion ku tokezimi eshte bere sipas projektit duhet te tokezohe ne perputhje me projektin.

Riparimi i percjellesave dhe OPGW te demtuar

Ndonje demtim i shkaktuar ne percjelles ose OPGW duhet te raportohet menjehere te Perfaqesuesi i Sipermarresit , vendimi i te cilit per zevendesimin ose riparimin e tij eshte vendimtar.

Riparimi i demit do te behet ne menyren e treguar ose te aprovuar nga Perfaqesuesi Sipermarres me shpenzimet e Kontraktorit.

Demtimi eshte nje deformim ne siperfaqen e percjellesit qe mund te hetohet me sy ose te ndjehet. Demtimi perfshin prerje, gervishtje, çjerrje, abrazion, perdredhje, kuposje, ngritje te siperfaqes dhe skaje te thyera.

Kur, sipas mendimit të Perfaqesuesit të Sipermarresit, riparimi mund të konsiderohet i kenaqshëm, riparimet duhet të behen me kujdesin më të madh me leter zmerile shumë të imet, duke mbuluar me shufra të riparuar ose me prerje dhe shtesa.

Gervishtjet, perdredhjet ose seksionet e demtuara keq duhet të hiqen.

Kur demtimi i percjellesit dhe OPGW nuk i kalon dy shtresa alumini, kur nuk është thyer ose gerryer me thelle se një e treta e diametrit të tyre, mund të perdoren mbeshtjellese. Kur janë thyer me teper se dy shtresa, janë gerryer apo gervishtur me teper se një e treta e diametrit të tyre, seksioni i demtuar i percjellesit duhet të pritët dhe OPGW duhet të zevendesohet.

Kur ka demtim të perseritur në të njëjtin hark ose harqe të njepasnjeshem, të gjithë percjellesat dhe OPGW të ndikuara nga këto harqe duhet të zevendesohen.

Të gjitha demtimet e shkaktuara me radhe dhe mekanizmat e tjere të kapjes do të riparohen ose do të priten, siç kerkohet nga Perfaqesuesi i Sipermarresit, para se percjellesi të bjere plotesisht.

Veshjet riparuese të percjellesit dhe OPGW nuk duhet të perdoren pa lejen e Perfaqesuesit Sipermarres dhe duhet të jepen vetëm në rrethana perjashtuese. Nuk duhet të perdoren veshje riparimi në harqet që kryqezojnë linjat e energjise me tension më të larte se 1kV, linjat e telekomunikacionit dhe ndertesat si dhe në seksione të veçanta të harkut. Për të siguruar perdorimin e percjellesave dhe OPGW të pa demtuar, Kontraktorit mund t'i kerkohet të çmbeshtjelle edhe një here rrotullat e reja.

Kjo behet për shkak se demtimi nga Kontraktori duhet t'i ngarkohet shpenzimeve të Kontraktorit.

Bashkimi i percjellesave dhe OPGW

Bashkimi i percjellesave do të jënë të tipit me ngjeshje. Percjellesit duhet të perfundojnë në shtylla këndore dhe fiksohen me kompresion në girlandat terheqese.

Bashkimi i të gjithë percjellesave do të behet sa më afer të jete e mundur në të njëjtin pozicion. Të gjitha xhuntat që bëjnë ngjeshjen duhet të mbushen dhe të vishen me leter zmerile me beze për të krijuar një sipërfaqe të lemuar, pa zona të zhveshura e të mprehta, që mund të krijojnë kurore ose interference të radios. Kontraktori duhet të ofroje mjetet e nevojshme, duke perfshire mjetet e kerkuara për ngjeshje.

Në xhuntat dhe pjesët fundore, sipërfaqja e kontaktit të percjellesave, pjesët fundore, xhuntat në formë gjysme-harku, duke perfshire pjesët në kontakt me duart, duhet të jënë të ndritshme e të pastra dhe të veshura me një perberes të aprovuar para se të kryhen veprimet e ngjeshjes.

Kontraktori duhet të sigurojë që mos të shkaterroje fole zogjsh, të mos ketë mbitentodje të telave ose shtresave apo deformime e demtime të tjera të percjellesit ose OPGW. Prerja e shtresave të percjellesave dhe OPGW duhet të kryhen me mjete të posaçme për të parandaluar demtimin e shtresave të poshtme ose tubat e fibrave optike.

Kontraktori duhet të mbaje të dhëna lidhur me ngjeshjen, duke treguar vendin e saj, datën e montimit, dhe emrin e punonjesit përgjegjës për montimin.

Kur sipas të dhënave të një punonjësi të veçantë tregohet në mënyrë të perseritur një performancë e ulët poshtë standardit të kërkuar nga Kontraktori, ky me kërkesë të Përfaqësuesit të Sipermarresit, pezullon operacionet e venies së xhuntave dhe e zëvendëson menjëherë punonjësin me një personel të kualifikuar për të riparuar pikat përkatëse me shpenzimet e tij.

Të gjitha xhuntat e percjellesit duhet të vendosen në një hark të pakten 5m larg nga mashat e kapjes dhe mashat e tendosjes ose pjesët ngjeshëse fundore. Nuk duhet të ketë më tepër se një xhunte të tilla për percjelles në një hark.

Venia e xhuntave nuk do të lejohet në një hark midis dy shtyllave të tensionit pranë njera-tjetres dhe kur bashkohen ose vihen terthor mjetet e mëposhtme: rruge, linja energjie, linja telekomunikacioni, ndertesa.

Venia e xhuntave duhet të bëhet në kohë me shi ose naten. Për të zhvilluar fuqinë mekanike dhe përcjeshmerinë elektrike, instalimi i xhuntave ngjeshëse duhet të mbikqyret me kujdes për të siguruar që xhuntat të jenë kryer si duhet.

Varja

Percjellesit dhe trosi OPGW do të varen në përputhje me tabelat tension/shigjete llogaritur nga Kontraktori dhe të miratuara nga Punedhësit. Me parë Kontraktori të paraqesë për miratim llogaritjet e tij Punedhësit. Tensionet dhe shigjetat e llogaritura duhet të sigurojnë që përcjuesit dhe OPGW do të vendosen mënyrë të tilla që të arrihet tensionet kërkuara finale pas 10 vitesh në shërbim.

Venia e fashetave

Gjithë percjelleset dhe OPGW duhet të shënohen saktësisht për venien e fashetave në të gjitha shtyllat në të njëjtën ditë duke ndjekur perkuljen përfundimtare.

Venia e fashetave me këthese do të llogaritet nga Kontraktori dhe të shënohet duke përdorur metodën e aprovuar nga përfaqësuesi i sipermarresit dhe nuk do të demtoje percjellesat dhe OPGW.

Instalohen shufra të forta në të gjitha pikat e percjellesit dhe OPGW. Këto shufra duhet të centrohen me kujdes në mashën shtrenguese. Mashat shtrenguese duhet të instalohen dhe rregullohen në mënyrë të tilla që izoluesi në pozicionin e tij përfundimtar të jetë në plan vertikal përmes aksit të strukturës.

Kontraktorit nuk i lejohet ndonjë kompensim shtesë për të bërë heqje, ri-instalim ose zëvendësim të shufrave nëse kërkohet.

2.4.5.5 Instalimi i izolacionit dhe armatures

Manovrimi dhe instalimi

Izoluesit dhe pajisjet e montuara do të ngelen në kutite e tyre dhe do të hiqen vetëm para se të ngrihen shtyllat dhe duhet të levizën me kujdes për të evituar dëmtimet.

Izoluesit duhet të pastrohen menjehere para se të ngrihen në struktura me rrobe të bute për të hequr pluhurin dhe mbetjet e depozituara. Nuk duhet të perdoren furça geryese dhe ato me tel.

Ngritja duhet të behet me vinça dhe mjete të aprovuara për të evituar demtimet.

Instalimi

Gjithë pjesët fizike dhe grupet izolues të linjes instalohen në përputhje me skicat dhe gjithë mekanizmat e mbylljes, dhe duhet të vendoset kundra në mënyrë të rregullt.

Brenda mundësive, këto kundra ose shufra bllokuese apo mekanizma të tjere mbylles duhet të instalohen në mënyrë të dukshme nga trupi i strukturës. Nuk duhet të perdoren fije izoluese si shkalle dhe Kontraktori duhet të ofrojë shkalle të pershtatshme për të arritur në fund të percjellesit të grupit izolues.

Shuariesit e vibrimeve duhet të vendosen me kujdes sipas rekomandimeve të studimit të shuariesve dhe rekomandimeve të prodhuesit.

Në rastin e shuariesit të instaluar në OPGW, masat shtrenguese duhet të pershtatet me saktësi me diametrin OPGW duke përfshirë shufrat e forta mbrojtëse.

Pasi kryhet e gjithë puna e grupeve izoluese në një shtyllë, izoluesit duhet t'i behet një pastrim përfundimtar me një rrobe të bute.

Të gjitha xhuntat ngjeshese duhet të shtypen në praninë e përfaqësuesit të sipërmarresit.

Në xhuntat dhe pjesët fundore, sipërfaqet e kontaktit të percjellesit dhe xhuntat duhet të pastrohen dhe të vishen me një përberës të aprovuar para se të behet montimi.

Distancatori për të dy percjelleset çift duhet të instalohen në përputhje me rekomandimet e studimit të kllapave dhe rekomandimet e prodhuesit. Ato shpërndahen në mënyrë efektive përgjatë harqeve në intervale të pabarabarta, por në minimum 2m nga një xhunte e mesit, veshje riparuese, ose ndonjë shtesë tjetër e montuar në percjelles.

2.4.5.6 Kontrolli dhe testimi përfundimtar

Kontrolli përfundimtar

Në mbarim të konstruksionit të linjes së transmetimit, Kontraktori bën një kontroll përfundimtar dhe testim të punimeve. Programi i testimit përgatitet dhe paraqitet tek sipërmarresi/përfaqësuesi i sipërmarresit për aprovim për të gjithë testet. Data e testeve njoftohet me kohë në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e sipërmarresit/përfaqësuesit të sipërmarresit. Raporti i testit duhet t'i paraqitet sipërmarresit/përfaqësuesit të sipërmarresit për aprovim brenda dy javëve pas performancës së testit.

Kontrolli përfundimtar duhet të përfshijë por jo të kufizohet në:

- shterngimin e bulonave dhe fiksimit të pjesëve që i mungojnë shtyllës;
- heqjen e gjithë skelave dhe pajisjeve dhe pastrimit nga mbeturinat dhe papastërtitë e vendit;
- rregullimi i sipërfaqes së demtuar, bazamentin kundër rreshqitjes, dhe masat e kontrollit kundër geryerjes, kur kjo drejtohet nga përfaqësuesi i Kontraktorit apo kur kërkohet nga autoritetet apo ligjet në fuqi;

- heqjen e materialeve të rena në ambientin përreth, si mbeturina materialeve të përdorura gjatë punës;
- pastrimin e plote të pemeve që shkaktojnë rrezik dhe evitimin e të tjerave që paraqesin rrezikshmeri;
- riparimi dhe shndërrimi në rrugë të kalueshme që do të përdoren për qëllime mirembajtjeje;
- kontrollin e pllakave të fazes në të dyja anët e gjithë pikave të linjes;
- matjen e parametrave OHTL dhe atyre të komunikimit (OPGW).

Testimi

Kontraktori është përgjegjës për kenajtjen e përfaqësuesit të sipërmarresit kur linjat janë gati për t'u testuar dhe duhet të behen testet në praninë e tij dhe të udhëzuar nga përfaqësuesi i sipërmarresit. Nëse vëhet re defekt, zëvendësimet apo riparimet e nevojshme ose korrigjimi i gabimeve në instalim për kenajtjen e përfaqësuesit të sipërmarresit mbulohen me koston e Kontraktorit.

Para se të energjizohet linja, Kontraktori duhet t'i ofrojë përfaqësuesit të sipërmarresit me deklarate me shkrim që personeli dhe gjithë pikat e perkohshme të ngritjes nga toka janë tërhequr dhe linjat janë gati për të përballuar energjinë.

Në linjë duhet të kalohet energjia me tension të plote pune para përdorimit dhe rregullimit, dhe teste të tilla që përfaqësuesi i sipërmarresit dëshiron t'i bëjë në të gjithë linjen sipas standardeve të praktikuara të përfaqësuesit të sipërmarresit duhet të asistohen nga Kontraktori që duhet të ofrojë një punë të tillë, transport dhe asistencë tjetër që kërkohet pa shpenzime të tjera.

Para se linja të kompletohet plotësisht, duhet të kryhen testet e mëposhtme (si minimum).

Per linjen e energjise

- testet që provojnë energjinë e vazhdueshme elektrike të përcjellesit për secilën fazë, me lidhje telefoni ose një metode tjetër alternative të aprovuar dhe të dëshmuar nga përfaqësuesi i sipërmarresit;
- testet e izolimit për secilën fazë, të dëshmuar nga përfaqësuesi i sipërmarresit;
- matjet e rezistencës elektrike të sistemit të tokezimit të shtylles me anë të instrumenteve me frekuencë të lartë të ofruar nga Kontraktori dhe të aprovuar nga përfaqësuesi i sipërmarresit;
- performanca OPGW, duke përfshirë testet OTDR;
- matjet e parametrave elektrike OHTL (rezistencën e plote të linjes etj.).

Data e marrjes në dorezim.

Me mbarimin e testimit dhe kontrollit përfundimtar, Kontraktori duhet t'i dorëzojë përfaqësuesit të sipërmarresit një deklarate me shkrim që vërteton se linja është e plote në çdo aspekt dhe të gjitha tokezimet e vendosura nga kontraktori janë hequr dhe secili

anetar i stafit të kontraktorit është informuar se asnjë nuk lejohet të punojë në linjë pa lejen e leshuar dhe të firmosura nga përfaqësuesi i sipërmarrësit.

Mjetet, pajisjet dhe mjetet e kembimit që kërkohen për mirëmbajtjen dhe linjen e transmetimit do të dorëzohen sikur është detajuar në programet e çmimit.

Te gjitha skicat dhe dokumentacioni do të ofrohen sipas kontrates.

2.5 Specifikimet teknike për lyerjen me bojë të shtyllave metalike

2.5.1 Të përgjithshme

Të gjitha konstruksionet metalike të shtyllave të linjave të tensionit të lartë 400, 220, 110 kV, që janë parashikuar për lyerje me bojë janë prej çeliku të pagalvanizuar. Për mbrojtjen nga korrozioni, këto konstruksione si rregull lyhen me bojë të posaçme. Efekti korrodues i sipërfaqeve të konstruksioneve sjell dobësimin e konstruksioneve dhe për pasojë amortizimin e shtyllave.

Korrodimi i konstruksioneve të linjave të transmetimit ka arritur në nivele relativisht të larta dhe procesi i mbrojtjes nga korrozioni i tyre kërkon përdorimin e një teknologjie specifike për të patur jetëgjatësi në mbrojtjen e tyre.

Këto specifikime përfshijnë furnizimin e materialeve të nevojshme dhe kryerjen e të gjithë zërave të punës për realizimin e mbrojtjes nga korrozioni të konstruksioneve metalike të shtyllave të linjave që janë parashikuar për lyerje me bojë.

2.5.2 Vëllimi i furnizimit dhe shërbimet

Në këtë paragraf do të jepen volumet e furnizimit për të realizuar mbrojtjen nga korrozioni të konstruksioneve metalike të shtyllave të linjave të transmetimit të parashikura për lyerje me bojë.

Projekti konsiderohet "me çelësa në dorë" dhe kontraktori do të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme si:

- a) Furnizimin e materialeve
- b) Kryerjen e punimeve
- c) Paisjet e nevojshme
- d) Transporti
- e) Taksat doganore
- f) TVSH
- g) Çdo gjë tjetër që lidhet me realizimin e këtij projekti, pavarësisht se mund të mos jenë shprehur të detajuara në këtë specifikim.
- h) Kontraktori do të mbulojë dhe kostot që nevojiten për transportin e materialeve, personelit dhe paisjeve, për shtyllat që ndodhen në pika të largëta dhe terrene të vështira.
- i) Në këtë kontratë do të realizohet lyerja me bojë e konstruksioneve metalike të shtyllave të linjave që do të jepen nga OST sh.a.

2.5.3 Vendi i kryerjes së punimeve

Punimet do të kryhen në të gjitha shtyllat e linjave që do të jepen nga OST sh.a. Ofertuesi është i detyruar të inspektojë në vend trasetë e linjave, rrugët e mundëshme për vajtjen deri tek shtyllat që gjenden larg rrugëve dhe në lartësi dominuese, si dhe nivelin e korrodimit të shtyllave.

2.5.4 Siguria në punë

Kontraktori mban përgjegjesi të plote për sigurinë në punë të punonjësve. Procesi i punës do të realizohet kryesisht në kushtet kur linjat janë në punë, nën tension. Për punime ku është e domosdoshme ndërprerja e tensionit, sidomos për ndërhyrjet në lartësi, Kontraktori duhet të paraqesë kërkesë me shkrim për miratim në OST sh.a., duke shënuar/sqaruar në mënyrë të hollësishme grafikun/datat dhe orët e caktuara për këto ndërprerje.

Kontraktori duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurinë në punë për punonjësit që punojnë në lartësi dhe në prani të tensionit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi.

Punonjësit që do të punojnë në lartësi dhe në prani të tensionit duhet të kenë eksperiencën e duhur dhe të trajnuar për punime të tilla dhe të kenë dëshminë përkatëse për punime në lartësi.

Punonjësit që do të kryejnë këto punime, sipas kategorisë së punimeve që kryhen në linjat me tension mbi 1000 volt; duhet të kenë grupin e sigurimit teknik në përputhje të plotë me rregulloren e sigurimit teknik.

2.5.5 Kërkesa teknike

Kontraktori duhet të përdorë një teknologji të përparuar dhe materiale cilësore për mbrojtje nga korrodimi të shtyllave prej çeliku të ekspozuara në kushte të vështira atmosferike. Agresiviteti gjërryes i mjedisit do të ketë efekt në:

- a) Lloji i bojës që përdoret për mbrojtje
- b) Trashësia totale e një sistemi boje
- c) Përgatitja e sipërfaqes së kërkuar
- d) Intervali minimal dhe maksimal i riformimit

Kontraktori duhet të kryej të gjitha proceset e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e plotë nga korrozioni të shtyllave, për një periudhë kohe jo më të vogël se 10 (dhjetë)vjet.

Punimet të kryhen duke pasur bazë specifikimet që jepen për këto lloj punimesh në standartin EN ISO 12944 në tërësi, (në veçanti: ISO 12944-5 Corrosion protection of steel structures by protective paint systems. Protective paint systems) dhe standartet referente të tij.

Bojërat të jenë të pajtueshme me ambientin (përmbajtja e komponimeve organike të pa qëndrueshme VOC- compatible).

Proceset e lyerjes për mbrojtjen nga korrozioni do të jenë si me poshte:

1. Pastrim mekanik i sipërfaqes së shtyllave nga të gjitha papastërtitë. Pastrim mekanik i gjithë pjesëve të korroduara, veçanërisht brinjëve, këndeve, traversave vertikale, me anën e një furçe metalike, letër zmerile, etj, deri në daljen e metalit të pastër.
2. Dorë e parë, trajtim me një epoksid poliamide shumëfunktionëshe (i njohur në këtë teknologji me termin "touch up") të brinjëve, këndeve, profileve kryesore vertikale, etj. Kjo shtresë do të përfaqësojë një bojë antindryshk të cilësisë së parë, me trashësi të cipës së thatë, DFT jo më të vogël se 125 mikron(μm).
3. Një shtresë e plotë me epoksid poliamidë shumëfunktionëshe në të gjithë sipërfaqen e konstruksionit metalik të shtyllës me trashësi të cipës së thatë (dry film thickness), DFT jo më të vogël se 125 mikron(μm).
4. Një shtresë e plotë me poliuretan alifatik në të gjithë sipërfaqen e konstruksionit metalik të shtyllës me trashësi të cipës së thatë (dry film thickness), DFT jo më të vogël se 60 mikron(μm).

Në përfundim të procesit, trashësia totale e cipës së thatë në të gjithë sipërfaqen e konstruksionit metalik të shtyllës DFT, nuk duhet të jetë më e vogël se 310 mikron(μm). Ngjyra perfundimtare e shtyllave duhet të jetë gri (Platinum grey RAL 7036).

Karakteristikat kimiko-fizike të substancave për lyerje janë si vijon:

- Përbërësi i parë i solucionit për lyerje

1. Epoksidi Poliamid Multifunksional (Epoxy Polyamide)

Rezistent ndaj agjentëve atmosferikë, veçanërisht ujit dhe kripërave.

Rezistent/i patjetërsueshëm edhe në temperaturat nën 0°C.

Tharje e shpejtë pas lyerjes, jo më shume se 4 orë.

I aplikueshëm në të gjitha llojet e sipërfaqeve të trajtuara metalike dhe të betonuara në kushte të veçanta.

Të krijojë lidhje/aderencë të qëndrueshme me një gamë të gjerë substancash ekzistuese (bojërat e vjetra) të mbetura në sipërfaqet metalike të këtyre shtyllave.

Përqëndrimi i elementeve solide të epoksidit poliamid të jetë nga 65-70%.

Trashësia e shtresës së thatë pas lyerjes të jetë nga 100-160 micron për një shtresë (dore) lyerje.

Graviteti specifik afërsisht 1.2kg/l.

- Përbërësi i dytë i solucionit për lyerje

2. Poliuretan Alifatik (Aliphatic Polyurethane)

Nivel i lartë shkëlqimi/llustre në pjesët më të sipërme të mbulesës/shtresës së fundit. Rezistent/i patjetërsueshëm ndaj agentëve atmosferikë, duke ruajtur paprekshmërinë e sistemit të bojës; si dhe ngjyrën dhe shkëlqimin. Rezistent ndaj gërryerjeve, i fortë, fleksibël dhe i qëndrueshëm. I patjetërsueshëm/i ruajtur në një amplitudë të gjerë temperaturash nga -15/20 °C deri

në

mbi 50 °C.

Rezistencë të lartë` ndaj rrezeve ultra-violet UV.

Kimikisht rezistent ndaj spërkatjeve apo lagieve me agjentë acide, alkaline, tretës, solucioneve të kriprave (acide, neutrale dhe alkaline) dhe ujit.

Përqëndrimi i elementëve solide të poliuretanit alifatik të jetë nga 55-60%.

Koha e tharjes për temperaturë ambjenti 20°C dhe trashësi të shtresës së thatë(DFT) prej 50 mikron të jetë jo më e madhe se një orë.

Graviteti specifik afërsisht 1.36 kg/l.

2.6 Tabelat e te dhenave teknike

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
110 kV OHL	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
Të Përgjithshmet			
Tensioni maksimal i paisjeve	kV/Hz	123	
Tensioni Nominal	kV	110	
Qëndrueshmeria ndaj tensionit nominal impulsiv të rrufesë (pik)	kV, peak	550	
Qëndrushmeria e izolacionit për kohë të shkurtër ndaj tensionit nominal të frekuencave industriale	kV, r.m.s.	230	
Sistemi I neutrit	-	Tokëzimi Solid	
Niveli I rrymës maksimale të lidhjes së shkurtër 3 fazore (1s)	kA	25	
Rryma e lidhjes së shkurtër për kontrollin termik të OPGW (1s)	kA	6	
Distanca e mbulimit të izolacionit për tensionin më të lartë të fazes për paisjet (123 kV) min.:	mm/kV	20	
Kufiri i radio zhurmave për testin e radio interferencave të ghirlandave të izolatorëve, morsetereive etj.	dB mbi 1 µV	46	
Masat mbrojtëse nga korrozioni			
Galvanizimi i pjeseve metalike, morseterive, etj.	µm	85	
Galvanizimi i bulonave, dadove e rondeleve	µm	55	
Përcjellësi	-	ACSR 120/20 sipas EN 50182)	

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
110 kV OHL			
Të dhënat e Linjës			
Numri i qarqeve dy	-	1	
Numri i përcjellësve për faze	-	1	
Faktorët e pjesëshëm te sigurise të materialeve (Y_M)			
Seksionet e strukturës së celikut, pllaka, etj.		1.10	
Bullonat		1.25	
Betoni		1.5	
Hekuri i armimit		1.2	
Të dhënat e tokës		2.0	
Përcjellësi dhe OPGW nën kushtet maksimale të ngarkesës		1.25	
Izolatorët dhe paisjet nën kushtet normale të ngarkesës		2.5	
Izolatorët dhe paisjet nën kushte e ngarkesave ekstereme		1.7	
Materialet e përdorura			
Përbërësit e strukturës	-		
Cilësit			
- pjesët kryesore që punojnë në shtypje	-	EN10025 S355J2 G3/G4 S235/J2 G3/	
- për pjesët e tjera	-	G4	
Bulonat dhe Dado	-	ISO 898	
cilësia e bulomave dhe dadove:	-	5.6 or 8.8	
diametri i bulonave lidhes (min.)	mm	16	
Tensioni i lejuar për përbërësit strukturore, bulonat dhe dadot përkatëse	-	EN1993-1-1 EN50341-1-J	
Bulonat për lidhjet e sigurta me rondele dhe rondele suste		Po	
Te gjitha pjesët e strukturës metalike të jenë të galvanizuara	-	Po	
Shtresa e zinkut - për seksionet e celikut	µm	85	
- për bulonat dhe dado	µm	55	
Cilësia dhe kontrolli në përputhje me		ISO 1461	
Diametri min. dhe numri i bulonave ne pikat e tensionuara lidhese te elementeve			

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
110 kV OHL			
• Diametri i bulonit	mm	16	
Koeficienti i perkuljes gjatesore per i elementet e shtyllave - L/r			
• Këmbe kryesore, stub dhe elementet kryesore të traversës që punojnë në shtypje	-	120	
• Të gjithë elementët e tjerë që punojnë me ngarkesa te llogaritura	-	200	
• Elementë të pa ngarkuar (redundant) me ngarkesa te pa llogaritura	-	250	
• Vetëm per elementët që punojnë në tërheqeje	-	300	
Trashësi minimale (t) e elementëve prej celiku të shtyllës do të jenë si më poshtë:			
• Këmbe kryesore, stub dhe elementët kryesorë të traversës që punojnë në shtypje	mm	6	
• Të gjithë elementët e tjerë që punojnë të ngarkuar	mm	4	
• Elementët të pa ngarkuar	mm	4	
• Pllakat përforcuese	mm	5	
Elementët "L" me të vegjël: me brinjë të barabarta		L45x45xt	
me brinjë jo të barabarta		L45x30xt	
Gjatësia max. e elementëve strukture	m	9	
Tolerancat e elementëve të përgatitur:			
• Variacioni max i gjeresise per gjatesine aktuale ndermjet pikave te mbeshtetjeve anesore.		1/1000	
• Elementet e perpunuar pa fundet e perpunuara per kontakt kushinete.			
• Elemente deri ne 3m gjatësi	mm	± 1.5	
• Elemente me gjatesi me shume se 3m			
• 3m deri 6 m	mm	± 2.5	
• më shumë se 6 m	mm	± 3	
Percjellesi			
Percjellesi i fazes			
Te dhena te pergjithshme			
Prodhuesi	-		
Projekti sipas standartit (konstruksioni dhe materiali)	-	EN 50182	
Seksioni nominal:			

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
110 kV OHL			
Alumin	mm ²	120.05	
celik	mm ²	20	
Gjithsej	mm ²	141.4	
Diametri i Percjellesit	mm	15.5	
Struktura e percjellesit /thurja::			
Alumin:	No x d (mm)	26 x 2.42	
Celik:	No x d (mm)	7 x 1.9	
Ngarkesa shkateruese perfundimtare, min.	kN	44.5	
Tensioni max. i punes	N/mm ²		
EDS (15°C, pa ere)	N/mm ²		
Rezistenca per rr.vazhduar 20 °C, max.	Ohm/km	0.2376	
Pesha:	kg/km	491	
Moduli i Elasticitetit	N/mm ²	77000	
Koefiçienti i zgjatimit linear	1/°C	1.89 E-05	
Gjatesia e percjellesit ne baraban	m		
Pesha bruto e barabanit perfshire percjellesin	kg		
Kapaciteti termik afat gjate i rrymes (per 40 °C tem. ambjenti, 0.5 m/sec shpejtesi ere, radiacion diellor 1000W/m ² per 60 °C temp. max. e percjellesit)	A		
Izolatoret dhe armatura (morseteria)			
Prodhuesi i izolatoreve			
Prodhuesi i armatures			
Informacioni I pergjithshem dhe te dhenat			
Qendrushmeria ndaj tensionit max ne kohe te lagesht nje minute	kV	230	
Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv 1.2/50 ms - positive	kV	550	
Distanca min. e mbulimit te izolacionit per girlande	mm	3075	
Tensioni radio interferencave			

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
110 kV OHL	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
- Tensioni i testimi	kV		
- Maksimum RIV mbi 1μV	dB		
Distanca e hapjes se elektrodave	mm		
Provat e testimit ne perputhje me :	-		
Numri I izolatoreve per girlande			
- Girlande varesë "I" teke	-		
- Girlande varesë dopio	-		
- - Girlande terheqese teke	-		
- - Girlande terheqese dopio			
Gjatësia e përgjithshme e kompletit të izolatorëve:			
- Girlande varesë Teke	mm		
- Girlande varesë dopio	mm		
- Girlande terheqese teke	mm		
- Girlande terheqese dopio	mm		
Ngarkesa mekanike minimale e prishjes			
- Girlande varesë teke	kN		
- Girlande varesë dopio	kN		
- Girlande terheqese teke	kN		
- Girlande terheqese dopio	kN		
Tipi i Izolatorit per girlandat varesë dhe terheqese			
IEC marketim			
Materiali izolues		Xham i temperuar	
Diametri i bashkueseve	mm	20	
Ngarkesa minimale elektro-mekanike e shkaterimit	kN	70	
Gjatesia e izolatorit	mm		
Diametri i diskut	mm		
Gjatesia minimale e rruges elektrike te mbulimit te pjeses izoluese te izolatorit	mm		
Tensioni minimal i mbulimit te izolatorit te lagur	kV		
Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv -min	kV		
Tensioni minimal i shpimit te izolatorit	kV		
IEC marketim			
Materiali izolues		Xham I temperuar	
Masa (diametri) e bashkueseve	mm	20	

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
110 kV OHL			
Ngarkesa minimale elektro-mekanike e shkaterimit	kN	120	
Gjatesia e izolatorit	mm		
Diametri i diskut	mm		
Gjatesia minimale e rruges elektrike te mbulimit te pjeses izoluese te izolatorit	mm		
Tensioni minimal i mbulimit te izolatorit te lagur	kV		
Qendrueshmeria ndaj tensionit impulsiv -min	kV		
Tensioni minimal i shpimit te izolatorit	kV		
Paisjet per setin e izolatoreve			
Informacion i pergjithshem dhe te dhenat			
Prodhuesi	-		
Standart per	-		
- Projektimin	-		
- materialet dhe ndertimin	-		
- Testimi ne fabrike	-		
- Te gjitha materialet te jene te galvanizuara	-	Po	
E gjithe morseteria duhet te jete e zinkuar minimum mbulesa e zinkut:			
- te gjithe komponentet	µm	85	
bulonat, dadot dhe rondelet	µm	55	
Lloi i galvanizimit	-	I nxehte i thelle	
Cilesa dhe provat ne perputhje me	-	ISO1461	
Materialet qe do te perdoren per			
- morsetat mbajtese	-		
- morsetat terheqese	-		
- veth	-		
- fashete me sferë	-		
- xhunto terheqes	-		
- pllake hekuri trekendeshe	-		
- bulona dhe dado	-		
- kopilje per bulona			
Briret mbrojtës per girlandat e izolatoreve			
Vizatimi dhe specifikimet perkatese	-		

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
110 kV OHL			
Unaza e bririt te siperm	-	Aliazh çeliku	
Unaza e bririt te poshtem	-	Aliazh çeliku	
Material	-	çelik	
Paisjet e Arcing jane te galvanizuara	-	Po	
Lloji i galvanizimit	-	I nxehte + I thelle	
Fundi i paisjes se poshteme paisur ne forme sferë	-	Po	
Lloi i lidhjes tek ghirlanda e izolatorev	-		
Paisje per percjellesit e fazes			
Prodhuesi	-		
Standarti	-		
Pjeset metalike jane te galvanizuara	-		
Lloji i galvanizimit	-		
Cilesia dhe testimi korespondojne me	-	IEC 61284	
Te dhenat specifike per morseterin terheqese (percjellesi i fazes)			
- Tipi			
- Menyra e lidhejs me percjellesin xhunto (bokull) me kompresion te ndara te mberthyera me bulona ne trupin e morsetes	-		
Materiali perdorur	-		
- Pjesa e jashteme e xhuntos		Rezistence e larte korozive Aliazh Al	
- Pjesa e brendeshme e xhuntos		Celik i pandryshkshem	
- Kopilje			
- Koke lidhese me bulon	-		
I pershtatshem per seksionin:	mm ²		
Te dhenat specifike per morseterin shtylles (percjellesi i fazes)			
- Tipi	-		
- Menyra e lidhejs me percjellesin me presim	-		
- Materiali perdorur		Rezistence e larte korozive Aliazh Al	

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
110 kV OHL			
Metoda e prodhimit			
I pershtatshem per seksionin:	mm ²		
Te dhena specifike per bashkuset (percjellesi i fazes)			
- Tipi	-		
- Materiali perdorur per: pjeset jashteme	-	Rezistence e larte korozive Aliazh Al	
- Materiali perdorur per pjeset e brendeshme	-	Rezistence e larte korozive Aliazh Al	
- I pershtatshem per seksionin:	mm ²		
Te dhena specifike per riparimin e mbeshtjellesve (percjellesi i fazes)			
- Tipi	-		
- Materiali	-		
- I pershtatshem per seksionin	mm		
Qetesuesit kunder vibrimeve per percjellesit	-		
Prodhuesi	-		
Tipi	-		
Material I perdorur per			
- Kundra Peshat			
- Kabell Elastik			
- Ttrupi I morsetes dhe mbajtesi			
- Pjeset prej hekuri dhe çeliku te jene te galvanizuara	-	yes	
Lloj I galvanizimit	-	I nxehte I thelle	
Cilesia koresponduese me	-		
Pesha e qetesuesit te jete instaluar ne			
Distancat e qetesuesit nga morseta dhe nga qetesuesi tjetër ne rastet kur jane dy.	mm		
Bulonat e morsetave			
Materiali			
- Çelik i pa ndryshkshem	-	Po/Jo	
- çelik i zinkuar	-	Po/Jo	

LINJA 110 KV ULEZ – BURREL			
Performanca dhe kriteret e projektimit	Kerkesat minimale		Oferta
	Njësia	Te dhënat	Të dhënat
110 kV OHL			
- forca terheqese, aftesia mbajttese	N/mm ²	80	
-momenti tendoses	Nm	<44	
Qendrueshmeria e materialeve jo metalike ndaj temperatures	0C	0-85	
Tensioni perkules max. i percjellesit	µm	=<150	
Jetegjatesia e pritur e percjellesit	Vite	100	
Diametri i vrimes se largimit te ujit	mm	Min 6	

Shenim: Në respekt të nenit 23 të LPP – së, në të gjithë rastet kur në Specifikimet Teknike përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Nr.	Nr. Analizë	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total
1. Punime demontimi shtylla dhe linja ekzistuese						
1		Demontim + mbledhje ne baraban 3 fije teli(percjellesa) me makineri, alumin-celik, me seksion ALC 95/15 mm ² .	km	16.2		
2		Demontim denfera ne linjat T/L 110 kV ne shtylla ndermjetese me percjelles te terhequr	shtylla	46		
3		Demontim denfera ne linjat T/L 110 kV ne shtylla ankerore me percjelles te terhequr	shtylla	11		
4		Demontim punime izolacioni+morseterite TL 110 kV, percjelles 95/15 mm ² , girlanda teke TT), ankerore shtylle me nje qark	shtylla	46		
5		Demontim punime izolacioni + morseterite TL 110 kV, percjelles 120/20 mm ² , (girlanda VT). Ndermjetese me nje qark	shtylla	46		
Shuma 1						
2. Punime montimi i shtyllave dhe shtrimi i linjes						
1		Betoni monolit me çakell C 25/30 + aditiv per riparimin e kokave te bazamenteve te demtuara te shtyllave.	m ³	7.296		
2		F.v. detaje metalike (hekur profil L 45X4 deri L 60X5 + riparim saldimi)	ton	2		
3		F.v. hekur betoni deri ø 10 mm	ton	0.15		
4		F.v. hekur betoni ø ≥ 12 mm	ton	0.1		
5		Germim dheu me ekskavator , 0.25 m ³ , toke zak, kategoria III,per rruget t=20 cm me shk ne mjet 30% (pjesa tjeter mbushje bankinash)	m ³	1509		
6		Transport dumper dheu 10 km, 30% e dheut	m ³	452.7		
7		Transport me buldoz.S/80-100kf ne zvallke 50 ml (vendepozitimi i dherave)	m ³	453		

		(4800x0.038)				
8		Bojatisje shtylla metalike, 2 minio + 1 vaji, me krahe	ton	158.85		
9		F.v. percjelles ACSR 120/20 mm ² me nje qark (tre fiye)	km	16.2		
10		F.v. tuba presimi per percjelles ACSR 120/20 mm ²	copë	24		
11		F.v. morseta mbajttese teli dhe trosi dhe heqje karukola per linjat 110 kV, 1 qark	shtylla	46		
12		F.v punime izolimi, ne shtyllat ndermjetese 110kV me 1 qark, tel 120/20 mm ² tek girland V.T (1x8 izolatore) vares tek.	shtylla	8		
13		F.v punime izolimi, ne shtyllat ndermjetese 110kV me 1 qark, tel 120/20 mm ² mm ² dojo girland V.D (2x8 izolatore) vares tek.	shtylla	38		
14		F.v punime izolimi elektrik ne linja + morsete terheqese, TL- 110 kV me 1 qark, ne shtylla ankerore percj. 120/20 mm ² mm ² dopio girland (2x9 izolatore girland), Tip TD	shtylla	2		
15		F.v punime izolimi elektrik + morsete terheqese ne linja, TL- 110 kV me 1 qark, ne shtylla ankerore, percj. 120/20 mm ² mm ² , tek girland (1x9 izolatore girland), Tip TT	shtylla	9		
16		F. v denfera ne linjat 110 kV, shtylla Ndermjetese, nje qark me tel 120/20 mm ² , ne toke	shtylla	46		
17		F. v denfera ne linjat 110 kV, shtylla Ankerore, nje qark me tel 120/20 mm ² , te terhequr	shtylla	11		
18		Nderprerje e linjes TL 110 kV me me linje 110 kV	copë	2		
19		Nderprerje e linjes TL 110 kV me me linja TM	copë	6		
20		Nderprerje e linjes TL 110 kV me me linja TU	copë	13		
21		Kalesa te perkoh. per shtrirje terheqje percjellesi (nderpr. rruge)	copë	4		
22		Ngarkim dhe shkarkim me autovinc 5t te materialeve (barabane percjellesash, lidhje shtyllash, arkat e shtyllave, barabane OPGW, fibra optike etj)	op	15		

23		Transport auto 60 km konstruksione metalike shtylla + percjellesa + OPGW+ izolatore + morseteri+etj (ngark.papershtatshme)	ton	15		
24		Ngritje kantieri (rrethim i perkoh. kolona+rrjete teli)	m ²	100		
Shuma 2						
3. HARTIMI I PROJEKTIT TE ZBATIMIT						
1		Projekt zbatimi per miratimin e lejes se ndertimit + projekti i zbatimit+ Preventivi përfundimtar (30%)- sisteme teknike	komplet	1		
Shuma 3						
SHUMA (1 + 2 + 3) pa TVSH						
TVSH						
TOTALI						

Shënim: Në zbatim të nenit 23 të LPP-së, në të gjithë rastet kur në preventivin e punimeve përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.

Shënim: Preventivi ne lidhje me kete projekt eshte paraprak. Vellimet e parashikuara jane te peraferta. Projekti i plote i zbatimit do te behet nga kontraktori dhe miratohet nga AK pas nenshkrimit kontrates.

Pra referuar VKM Nr. 914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kjo kontrate do te trajtohet si nje kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtim ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikonin e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

- 18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

- 19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porosinë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .
- 19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

- 20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

- 21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
- 21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.
- 21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.
- 21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

- 22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

- 23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:
- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
 - (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

- 24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

- 25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumatat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.
- 25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

- 26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.
- 26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.
- 26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

- 26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 27 Garancitë

- 27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.
- 27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 28: Çmimi i Kontratës

- 28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 29: Kushtet e Pagesës

- 29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.
- 29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.
- 29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqesë një deklaratë me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është permbyllur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të paguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.
- 29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
- 29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendrike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.
- 29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës

Neni 32: Forca Madhore

- 32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.
- 32.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.
- 33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonësën në Mbarimin e Punimeve

34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet

35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 36: Ndryshimi i Porosisë

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuara në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale

c) Korrigjime në sasi

- 36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.
- 36.5 Ndryshimi i porosisë nuk do të jete i vlefshëm nëse nuk formalizohet sipas kërkesave të Nenit 35 të ketyre kushteve të përgjithshme.

Neni 37: Preventivi për Njësi ose në Total

- 37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njësi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, preventivi për njësi do të përmbajë volumet e zërave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.
- 37.2 Preventivi për Njësi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

Neni 38: Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve

- 38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.
- 38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.
- 38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim

- 39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 42: Nënkontraktimi

42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësinë e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

42.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për punët që do të kryejë

42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

Neni 43: Transferimi i të Drejtave

43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 44: Sigurimi i Kontrates

- 44.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.
- 44.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 44.3 Sigurimi i kontratës do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 45: Baza Ligjore

- 45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 46: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

- 46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
- 46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 47: Përfaqsimi i Palëve

- 47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 48: Lajmërimet

- 48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 49: Llogaritja e Afateve

- 49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

Shtojca 19

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

KUSHTET E VEÇANTA Punët – Procedura e Hapur

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1: Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është OST sh.a.

1.2 Kontraktori është _____

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: _____

Neni 3: Drejtuesi i Projektit

3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: _____

3.2 Adresa/pika e kontaktit: _____

Neni 4: Kantieri

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i venddodhjes së objektit që do të realizohet):
Linja 110 kV Ulëz-Burrel.

Neni 5 Data e Fillimit

5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: _____

Neni 6: Siguracioni

6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:

a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: _____

b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: _____

c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: _____

d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: _____

Neni 7: Inspektimet dhe Testimet

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: _____

Neni 8: Lloji i Kontratës

8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një

- Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- Kontratë me Shumë Totale

8.2 Pagesa për punët e kryera do të behet bazuar në projektin e detajuar të zbatimit të miratuar nga Autoriteti kontraktor. Kontraktori dhe AK referuar volumeve të sakta të projektit të zbatimit të miratuar, do të përcaktojnë dhe peshen në përqindje të secilit zë (volum) të lotit (grupit të zerave) të ofertes në bazë të cilit do të behen dhe pagesat.

Neni 9: Grafiku i Pagesës

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: _____

9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda _____ ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

9.3 Monedha e pagesës do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do të bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 10. Pagesa Paraprake

10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë do të jetë 20% e vlerës së kontratës. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

10.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda 30 ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.

10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme: Te zbritet në menyre proporcionale nga çdo fature deri në ezaurimin e pagesës paraprake.

Neni 11. Shërbimet në Lidhje me to

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura

Neni 12. Zbritja e garancisë së kontratës

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

Shtojca 20

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data_____]

Për : [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (objekti)

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimit Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] t'i jetë akorduar kontrata, ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve] në një shumë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [emri i autoritetit kontraktor]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

Shtojca 21

FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ankesë drejtuar : *Autoriteti Kontraktor*

Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërisht).

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Seksioni II. Informacion për Procedurën

1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).

2. Autoriteti Kontraktor

Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

3. Vlera e Përlllogaritur e Prokurimit

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.

5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Data (viti/muaji/dita)

6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.

3. Lista e Shtojcave

Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë.

*Mundësisht bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

Nr. Faks:

E-mail:

Nënshkrimi dhe Vula e Ankuesit

Shtojca 22

DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR (KU TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA) PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME

[Përdorimi i këtij draft marreveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

Nr __

DATA:

Kjo kontratë lidhet më [data], midis [emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor] tani e tutje të referuar si “Autoriteti Kontraktor” dhe [emri dhe adresa e Kontraktuesit] të përfaqësuar nga [përfaqësuesi], tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi”.

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [data] bie dakord të realizojë punimet, ashtu siç janë të specifikuar në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontratë
- Formularin e Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formularin e çmimit të ofertës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i marrëveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punëve në vijim.
[përshkrimi i përgjithshëm]
- 1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marreveshje.
- 1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara
- 1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do t’i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më

shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra/shërbime janë treguar në Formularin e Çmimit të Ofertës.
- 2.2 Çmimet e njësisive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

Nënshkrimet dhe Datat

Për Kontraktuesin		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:		Emri:	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Shtojca 23

DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR (KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA) PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME

Emri i Autoritetit Kontraktues,

Dhe

Emri i Kontraktuesit

Bien dakord si vijon:

Të nënshkruajnë këtë marrëveshje kuadër për objektin < vendosni titullin > me numrin identifikues : <*vendosni Numrin e Prokurimit*>

Neni 1 Objekti

1.1 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkurrencës vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

1.2 Kjo marrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

1.3 Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

Neni 2 Detyrimet e Paleve

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë kontraktuesit "Ftesën për Oferte" kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdoherë që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër

3.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

Neni 4 Procesi i mini-konkursit

- 4.1 Procesi i mini-konkursit do të kryhet me të gjithë operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë /mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.
- 4.2 Autoriteti Kontraktor do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.
- 4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë /mall /shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Ofertë dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër

Nënshkrimet dhe datat

Për Kontraktorin		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri :		Emri:	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Shtojca 24

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR

Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja e Internetit _____

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion Qëndror	Institucion i Pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njesi e Qeverisjes Vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Seksioni 2 Objekti i Kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit _____

2.2 Lloji i “Kontratave për punë publike”

Realizimi i punëve	Projektimi dhe realizimi i punëve
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po Jo

Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me 1 Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Po Jo

2.4 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1. Fondi limit _____

2. Burimi i Financimit _____

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër _____

2.5 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë

ose

duke filluar nga // me përfundim në //

2.6 Ndarja në LOTE:

Po Jo

Nëse Po, numri i LOTEVE:

2.7 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka):

ose: nga në

2.8 Kontrate me nenkontraktim:

Po Jo

Seksioni 3 Procedura

3.1 Lloji i procedurës:

E hapur

3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët

ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme

lidhur me rëndësinë: Çmimi pikë

etj. pikë

3.3 Numri i ofertave të dorëzuara:

Numri i ofertave të rregullta:

3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo

3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të paaplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit

Po Jo

Seksioni 4 Informacion mbi kontratën

4.1 Numri i Kontratës: _____ **Data e Kontratës** / /

4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Faqja e Internetit _____

4.2.1 Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja e Internetit _____

4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):

Vlera _____ (pa TVSH) Monedha _____
Vlera _____ (me TVSH) Monedha _____

4.3.1 Vlera totale e nenkontraktimit : _____

Vlera _____ (pa TVSH) Monedha _____
Vlera _____ (me TVSH) Monedha _____

4.4 Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi / /

Shtojca 25

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja në Internet _____

2. Lloji i procedurës: _____

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër _____

4. Numri i referencës së procedurës/lotit _____

5. Fondi limit _____

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):

Vlera _____ me Tvsh Monedha _____

Vlera e nenkontraktimit _____ me Tvsh Monedha _____

7. Data e lidhjes së kontratës _____

8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktimit

Emri _____
Adresa _____
Nr. NIPT _____

Shtojca 26

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULIMIT

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____

Adresa _____

Tel/Fax _____

E-mail _____

Faqja në Internet _____

1. Lloji i procedurës: _____

2. Numri i Referencës: _____

3. Objekti i kontratës _____

4. Fondi limit _____

5. Arsyet e Anulimit:

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 24, pika

1: a) ;

b) ;

c) ;

ç) ;

d) ;

dh) ;

Etj. _____

6. Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi